

LIGJ

Nr.10 381, datë 24.2.2011

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë

SICPA Security Solutions Albania Sh. p. k.

dhe

SICPA SECURITY SOLUTIONS SA

**Kontratë Konçensioni mbi Krijimin
dhe Funksonimin e Sistemit të
Kontrollit të Pullave Fiskale**

Përmbajtja

Nr.	Titulli	Faqe
	Nenet	
1.	Përkufizime dhe Interpretime	7
2.	Vigjilenca e Duhur	10
3.	Dhënia e Koncesionit	10
4.	Data Efektive e Kontratës	13
5.	Plani i Zbatimit dhe Dizajni	14
6.	Testimi	14
7.	Vonesat në Zbatim- Dispozita të Përgjithshme	15
8.	Vonesat për shkak të Mospërbushjes së Koncesionarit	17
9.	Vonesat në Arritjen e Objektivave për shkak të Autoritetit, Prodhuesve ose Importuesve	18
10.	Shërbimet	19
11.	Nivelet e Shërbimit dhe Nivelet e Krediteve	20
12.	Pasojat e një Shkelje nga Autoriteti gjatë Periudhës Operacionale.	21
13.	Standardet	22
14.	Sigurimi i Cilësisë dhe Monitorimi	22
15.	Përmirësimi I Shërbimit	23
16.	Sistemi	23
17.	Vendosja e Cmimeve dhe Cështjet Financiare	24
18.	TVSH	25
19.	Përfaqësuesit	26
20.	Zbatueshmëria	26
21.	Nënkontraktimi	26
22.	Rishikimi i Shërbimit	27
23.	Auditimet financiare dhe të Cilësisë	27

24.	Regjistrat dhe Raportet	28
25.	Procedura e Kontrollit të Ndryshimit	29
26.	Stafi	29
27.	Ndryshimi i Kontrollit të Konçesionarit	30
28.	Ndryshim Tjetër Aksionar i Koncesionarit	30
29.	Shëndeti dhe Siguria	31
30.	Barazia dhe Diversiteti	31
31.	Të Drejtat e pronësisë Intelektuale	31
32.	Zbatimi i Ligjeve dhe Rregulloreve	32
33.	Licencat e lëshuara nga Autoriteti	32
34.	Detyrime të Caktuara të Mëmës	33
35.	Të Dhënat e Autoritetit	33
36.	Mbrojtja e të Dhënave	34
37.	Detyrime të Vecanta të Autoritetit	34
38.	Detyrimet e Përgjithshme të Autoritetit	34
39.	Vijimësia e Biznesit	35
40.	Rastet e Forcës Madhore	36
41.	Dëmshpërblimi	36
42.	Konfidencialiteti	38
43.	Përgjegjësia	40
44.	Siguracionet	42
45.	Detyrime të caktuara të Koncesionarit	42
46.	Deklarimet dhe Garancitë	42
47.	Siguria	45
48.	Të Drejtat dhe Detyrimet e Koncesionarit	47
49.	Zgjidhja	50
50.	Pasojat e Zgjidhjes	51
51.	Menaxhimi i Daljes	51

52.	Ndryshimet	51
53.	Garancia e Zbatimit	52
54.	Kalimi ose Rinovimi	53
55.	Heqja Dorë dhe Mjetet ligjore tërësore	53
56.	Marrëdhëniet ndërmjet Palëve	53
57.	Parandalimi i Korrupsionit	53
58.	Publiciteti dhe Emërtimi	54
59.	Veçueshmëria	55
60.	Sigurime të Mëtejshme Further Assurances	55
61.	Tërësia e Kontratës	55
62.	Të Drejtat e Palëve të Treta	55
63.	Njoftimet	56
64.	Gjuha	56
65.	Ligji i zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve	56

ANEKSET

Aneksi 1 – Përkufizimet

Aneksi 2 – Kërkesat e Autoritetit

Aneksi 3 – Propozimet për Zgjidhje të Koncesionarit

Aneksi 4 – Projektet për Pullat Fiskale

Aneksi 5 – Nivelet e Shërbimit

Aneksi 6 – Plani i Testimit

Aneksi 7 – Sigurimet

Aneksi 8 – Përgjegjësitë e Autoritetit, Prodhuesit dhe Importuesit

Aneksi 9 – Nënkontraktorët e Miratuar

Aneksi 10 – Plani i Zbatimit

Aneksi 11 – Kreditë e Shërbimit

Aneksi 12 – Garancitë e Zbatimit

Aneksi 13 – Stafi Kryesor

Aneksi 14 – Linjat e Prodhimit në Shqipëri

Aneksi 15 – Procedura për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve

Aneksi 16 – Procedura e Ndryshimit të Kontrollit

Aneksi 17 – Trainimi

Aneksi 18 – Pagesat dhe Tarifat

Aneksi 19 – Udhëheqja

Aneksi 20 – Standardet

Aneksi 21 – Regjistrimet

Aneksi 22 – Menaxhimi i Daljes

Aneksi 23 – Plani i Vazhimit të Biznesit

Aneksi 24 – Specifikime për Vendndodhjen e Prodhimit Qendror

Aneksi 25 – Porositja dhe Pagimi

Aneksi 26 – Direktivat e Zbatimit

Aneksi 27 – Perditesimet dhe Përmirësimet

KJO KONTRATË, nënshkruhet sot më _____ 2010 në Tiranë, Shqipëri

NDËRMJET:

- (1) **MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË** (më poshtë referuar si “**Autoriteti**”) emëruar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 922, datë 02.09.2009, Blvd. Deshmoret e Kombit NR.4, Tiranë, Shqipëri, në emër të Republikës së Shqipërisë,
- (2) **SICPA Security Solutions Albania Sh. p. k.** (më poshtë referuar si “**SICPA Albania**”) një shoqëri Shqiptare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numër L02120032R, me seli qendrore në Rrugën Murat Toptani, Qendra Eurocol, Kati 4, Tiranë, Shqipëri dhe
- (3) **SICPA SECURITY SOLUTIONS S.A.** (më poshtë e referuar si “**Mëma**”), një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Zvicerian me seli në 41 avenue de Florissant, 1008 Prilly, Zvicër.

KUSHTET PARAPRAKE

Ne baze te sa më poshtë:

- Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet”;
- Ligjit Nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për Akcizat”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922 datë 02.09.2009 “Mbi caktimin e Autoritetit për dhënien e konçisionit për prodhimin dhe kontrollin e pullave fiskale dhe miratimin e shtesës në procedurën selektive të konkurrimit dhënë shoqërisë”

PARATHËNIE:

- (A) Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë sipas Vendimit Nr. 922, datë 02.09.2009 dëshiron të japë të drejta për zhvillimin e Koncesionit dhe ka caktuar Ministrinë e Financave si autoriteti me të drejta për dhënien e këtij Koncesioni.
- (B) Autoriteti i dha Konçisionarit më 16 Nëntor 2009 kërkesat e tij në lidhje me Koncesionin të cilat I janë bashkëngjitur Aneksit 2 të kësaj Kontrate
- (C) Konçisionari i dha Autoritetit në 5 Shkurt 2010 propozimin e tij për zgjidhje që është bashkëngjitur Aneksit 3 të kësaj Kontrate për mënyrën se si Sistemi dhe Shërbimet që ai do të ofrojë do t’i përmbahen kërkesave të Autoritetit.

- (D) Autoriteti i ka dërguar Konçesionarit në 21 Qershor 2010 një njoftim caktimi/dhënie (Dokumenti Nr. 246913 datë 21 Qershor 2010 “Njoftimi i Dhënies”), duke pranuar në parim zgjidhjen e propozuar të Konçesionarit.
- (E) Kjo Kontratë parashtron kushtet dhe afatet sipas të cilave Autoriteti është i përgatitur të japë me Koncesion Konçesionarit dhe secila Palë pranon këto kushte dhe afate.
- (F) Palët pranojnë faktin se dhenia e Koncesionit është i një rëndësie shumë të lartë kombëtare dhe afatet për implementimin e projektit janë thelbësore. Palët pranojnë faktin se përmbushja e rregullt e detyrimeve të tyre sipas Kontratës, duke përfshirë bashkëpunimin dhe asistencën ndaj Palëve të tjera, ashtu sic përkufizohet shprehimisht në këtë Kontratë, janë thelbësore për zbatimin e projektit.
- (G) Më tej palët pranojnë se Sistemi është i ndërtuar për të gjetur dhe gjurmuar produktet që i nënshtrohen taksës së akcizës, dhe Pullat Fiskale synohet të shërbejnë si provë se taksat e akcizës është paguar, por Sistemi nuk është një mjet për mbledhjen e këtyre taksave të akcizës, mbledhja e të cilave mbetet përgjegjësi vetëm e Autoritetit. Rrjedhimisht, palët do të mundësojnë që Sistemi dhe Shërbimet e ofruara nga Konçesionari, nga njëra anë dhe procesi i mbledhjes së taksave i drejtuar nga Autoriteti në anën tjetër, secili do të ngelen sisteme të pavarura. Sipas nevojës, ndërhyrja ndërmjet Sistemit dhe Shërbimeve nga njëra anë dhe sistemeve dhe proceseve të Autoritetit nga ana tjetër për grumbullimin e taksave, Palët do të bashkëpunojnë për të optimizuar funksionimin e sistemeve dhe në rast të mosfunksionimeve materiale sistematike sic parashikohen në Aneksin 23, do të lehtësojnë ndikimet e mundshme negative në procesin e vjeljes së taksave përmes, për shembull, reduktimit të niveleve të shërbimit të Sistemit dhe Shërbimeve, dhe shkëputjes së përkohëshme të dy sistemeve, me qëllim mos-rrezikimin e funksionimit të procesit të mbledhjes së taksave.

DISPOZITAT OPERATIVE:

1. Përkufizime dhe Interpretime

1.1 Në këtë Kontratë, përkufizimet e dhëna në Aneksin 1 do të gjejnë zbatim.

1.2 Në këtë Kontratë, vetëm nëse konteksti e kërkon ndryshe;

1.2.1 fjalët e secilës gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër

- 1.2.2 fjalët e përdorura në njëjës ose shumës do të përfshijnë rrespektivisht shumësin dhe njëjësin;
- 1.2.3 cdo parathënie, deklaratë paraprake, Shtojcë, Tabela, ose Anekse janë një pjesë e kësaj Kontrate dhe do të formojnë tërësinë e kësaj Kontrate dhe referencat në Shtojcat, Tabelat dhe Anekset do të jenë referencat e Shtojcave, Tabelave dhe Anekseve të kësaj Kontrate, përveçse nëse Palët bien dakord ndryshe;
- 1.2.4 referencat e një Akti të Parlamentit, ndonjë dispozite ligjore ose instrumenti ligjor përfshijnë referencën për atë Akt Parlamentar, dispozite ligjore ose instrument ligjor të ndryshuar, të vazhduar ose të ri-miratuar herë pas here dhe me cdo rregullim të tij. Ndikimi i cdo ndryshimi të tillë, vazhdimi ose ri-miratimi në këtë Kontratë do të trajtohet në përputhje me Nenin 25;
- 1.2.5 fjalët si “përfshij” ose “duke pëfshirë” do të konsiderohen sikur të ndiqeshin nga fjalët “pa u kufizuar” ose “pa u kufizuar me”, edhe pse ato mund të mos ndiqen nga fraza ose fjalë të tilla;
- 1.2.6 referencat për “këtë Kontratë” ose “kjo Kontratë Koncesioni” ose për ndonjë kontratë ose dokument tjetër, do të interpretohen si referenca të kësaj Kontrate ose dokumentit të ndryshuar, modifikuar ose të plotësuar dhe sic janë hera-herës në fuqi, në mënyrë të ngjashme ato do të përfshijnë cdo referencë të cdo dokumenti që e amendon, modifikon ose plotëson atë, ose që lidhet me të, me shkrim ose i lëshuar në zbatim të tij ose në lidhje me kushtet e tij;
- 1.2.7 kurdo që kjo Kontratë i referohet një numri “ditësh” ky numër do t’i referohet ditëve kalendarike vetëm nëse ato përcaktohen si Ditë Pune;
- 1.2.8 cdo referencë për “një muaj” ose “një vit” do të interpretohet si referencë për një muaj ose vit kalendarik, vetëm nëse përcaktohet ndryshe në Vit Kontrate;
- 1.2.9 të në rast të mospërputhjes së ndonjë fjale me shkronjë të madhe, termi të përcaktuar, fraze, apo shkurtesë të parashikuar në Aneksin 1 me një dispozitë me shkronjë kapitale, fjale, termi, fraze apo shkurtesë të parashikuar kudo tjetër në këtë Kontratë, Shtojcë, Aneks ose ndonjë dokument tjetër bashkangjitur çdo Aneksi, përkufizimi i dhënë në Aneksin 1 do të ketë prioritet ndaj përkufizimit të dhënë në ndonjë Shtojcë, Aneks apo dokument tjetër bashkëngjitur secilit Aneks, vetëm nëse konteksti e kërkon ndryshe në këtë Kontratë. Në rast të ndonjë mospërputhjeje të kësaj Kontrate si një e tërë, me Shtojcat dhe Anekset, Palët do të bëjnë përpjekje së pari, për të zgjidhur këtë mospërputhje duke lexuar kontratën si një e tërë, ndërsa dispozitat që trajtojnë këtë çështje në mënyrë më specifike do të gjejnë zbatim. Nëse mospërputhja vazhdon të ekzistojë pavarësisht nga përpjekjet për të zgjidhur atë në mirëbesim, siç parashikohet

- në fjalinë e mësipërme, të gjitha dispozitat e kësaj Kontrate do të zbatohen për ta zgjidhur atë;
- 1.2.10 referencat për një person përfshijnë një shoqëri, korporatë, shoqatë apo autoritet ligjor;
- 1.2.11 referenca për cdo kontratë ose instrument janë të asaj kontrate ose instrumenti të ndryshuara, të zëvendësuara, të plotësuara, me rivendosjet e herë-pas-hershme
- 1.2.12 Referenca për cdo strukturë është:
- (a) nëse ajo strukturë zëvendësohet nga një organizatë tjetër, që supozohet ti referohet asaj organizate; dhe
 - (b) nëse ajo strukturë pushon së ekzistuari, vlerësohet t'i referohet organizatës që kryesisht shërben për të njëjtat qëllime ose objekte me atë strukturë.
- 1.3 Krerët në këtë Kontratë janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e saj.
- 1.4 Referencat për Shtojcat, Anekset dhe Nenet janë, vetëm nëse parashikohet ndryshe, referenca të Shtojcave, Anekseve dhe Neneve të kësaj Kontrate.
- 1.5 Pa çenuar Nenin 10.4, nëse ka ndonjë kundërshti ndërmjet Neneve dhe Anekseve të referuara në këtë Kontratë, ajo do të zgjidhet në përputhje me kushtin e mëposhtëm paraprak:
- 1.5.1 Këtë Nen dhe Aneksin 1;
 - 1.5.2 Aneksi 2;
 - 1.5.3 Aneksi 3;
 - 1.5.4 Aneksi 5;
 - 1.5.5 Aneksi 11;
 - 1.5.6 dhe ndonjë Aneks tjetër; dhe
 - 1.5.7 ndonjë dokument tjetër referuar ose bashkëngjitur kësaj Kontrate.
- 1.6 Sipas dispozitave të Neneve 6 deri në 9, as Pala Kryesore nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë Shkelje të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate për aq sa kjo Shkelje është shkaktuar nga një mosfunksionim ose vonesë nga ana e Palës Kryesore tjetër, gjatë

përbushjes së detyrimeve të saj sipas Kontratës. Në lidhje me ndonjë Shkelje (ose ndonjë rasti që, por për Nenin 1.6 përbën një Shkelje) të shkaktuar nga mosfunksionimi ose vonesa nga Pala tjetër Kryesore në përbushjen e detyrimeve të saj sipas Kontratës, Pala Kryesore e dëmtuar, do të njoftojë Palën tjetër Kryesore për këtë mosfunksionim ose vonesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data që Pala Kryesore e dëmtuar merr dijeni për shkaktimin dhe impaktin e mundshëm të saj.

2. Vigjilenca e Duhur

2.1 Konçesionari deklaron se ai:

2.1.1 ka bërë kërkime në lidhje me përbushjen e detyrimeve të tij sipas Kontratës duke përfshirë kërkimin e informacionit të nevojshëm nga Autoriteti dhe zgjidhjen e çdo çështjeje;

2.1.2 është i ndërgjegjshëm për Kërkesat e paraqitura në Aneksin 2 dhe propozon Zgjidhjen e paraqitur në Aneksin 3 si metodë e përbushjes së Detyrimeve; dhe

2.1.3 ka të gjitha njohuritë, të drejtat, pajisjet, programet kompjuterike, sistemet dhe stafin e nevojshëm për të përbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë aftësinë për të ofruar Zgjidhje.

2.2 Autoriteti deklaron se të dhënat e me shkrim të disponueshme për Konçesionarin janë të rifreskuara, të sakta dhe të vërteta, duke përfshirë Kërkesat.

3. Dhënia e Koncesionit

3.1 Sipas kushteve dhe afateve të paraqitura në këtë Kontratë (duke përfshirë Anekset) Autoriteti i jep Konçesionarit të drejtën ekskluzive për të kryer Shërbimet në lidhje me ofrimin dhe kontrollin e Pullave Fiskale në emër të Autoritetit, duke përfshirë por pavarësisht nga:

3.1.1 krijimi dhe mirëmbajtja e Objektivit Qendror të Prodhimit në ambientet që do të ofrohen nga Autoriteti, sic paraqitet më tej në Aneksin 24, i cili përbush kërkesat fizike, të sigurisë dhe teknologjike të paraqitura tek Kërkesat; dhe

3.1.2 ndërtimi, zhvillimi, financimi, prodhimi, testimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e Sistemit, të Sistemit Qendror Monitorues të Gjetjes dhe Gjurmimit, dhe të Njësive Kompjuterike gjatë Periudhës, sipas kushteve dhe afateve që paraqitetn tek Kërkesat, Zgjidhja dhe tjetërkund në këtë Kontratë duke përfshirë Anekset e saj; dhe

3.1.3 Printimi, Prodhimi dhe pajisja me Pulla Fiskale dhe Njësi Kompjuterike për Autoritetin dhe Struktura të tjera Shtetërore të emëruara nga Autoriteti gjatë Afatit pas Dates se Pare;

të gjitha në lidhje me Kërkesat, Zgjidhjen dhe termat e tjera që paraqiten në këtë Kontratë.

3.2 Koncesioni jepet për një periudhë që fillon në Datën Efektive dhe mbaron në ditën e përvjetorit të dhjetë të Datës Efektive (“Afati”); me kusht që, nëse kjo Kontratë përfundon më shpejt sipas kushteve të saj, “Afati” do të nënkuptojë dhe do të kufizohet në periudhën që fillon në Datën Efektive dhe mbaron në datën e përfundimit të kësaj Kontrate, në përputhje me termat e saj.

3.3 Afati do të shtyhet si më poshtë:

3.3.1 nëse ndodh një Rast i Forcës Madhore, Afati do të zgjatet për një periudhë shtesë të barabartë me periudhën e zgjatjes së këtij Rasti të Forcës Madhore;

3.3.2 nëse Autoriteti nuk arrin të përmbushë ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate në lidhje me sigurimin e një license, leje ose autorizimi të kërkuar nga Konçesionari, dhe kjo mospërmbushje çon në ndonjë vonesë në shkaktimin Dates se Pare, Afati to të shtyhet për një periudhë shtesë të barabartë me periudhën e kësaj vonese;

3.3.3 Nëse Autoriteti nuk arrin të përmbushë ndonjë prej detyrimeve të tij sipas Aneksit 8 të kësaj Kontrate, dhe kjo mospërmbushje rezulton në ndonjë pamundësi të Konçesionarit për të zbatuar ndonjë të drejtë apo për të zbatuar ndonjë detyrim sipas kësaj Kontrate, Afati do të shtyhet për një periudhë shtesë të barabartë me periudhën gjatë së cilës është duke vazhduar kjo pamundësi e Konçesionarit; dhe

3.3.4 afati mund të shtyhet për një periudhë shtesë të përcaktuar nga Autoriteti, që për çfarëdo arsye nuk është paraqitur më sipër, për aq sa Autoriteti duke vepruar në mënyrë të arsyeshme vendos se kjo shtyrje është e nevojshme ose e këshillueshme dhe Konçesionari e ka pranuar këtë shtyrje.

3.4 Në vijim të kërkesës me shkrim nga Konçesionari, Autoriteti do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të mundësuar që cdo Strukturë Shtetërore, nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Autoritetit lëshon cdo autorizim, licensë ose ndonjë tjetër leje të nevojshme për t’i mundësuar Konçesionarit zbatimin e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate me kusht që Konçesionari të ketë përmbushur të gjithë detyrimet për sigurimin e kësaj license, autorizimi ose leje.

- 3.5 Palët Kryesore pranojnë se gjatë Periudhës së Daljes, Konçesionari do të ofrojë Shërbimet e paraqitura në Aneksin 22 (*Menaxhimi i Daljes*).
- 3.6 Sipas zgjedhjes së Autoritetit, Shërbimet do të supozohet të përfshijnë krijimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi për printimin, Prodhimin, shpërndarjen dhe monitorimin e një tregu të sigurt të Pullave Fiskale për aplikimin e produkteve, përveç Produkteve, nëse ndonjë prej kushteve të mëposhtëm është përmbushur:
- 3.6.1 Konçesionari ka pranuar me shkrim se, duke iu nënshkruar plotësisht të secilit prej kushteve të paraqitura në Nenin 3.6, këto produkte shtesë do të përfshihen si Produkte brenda qëllimit të Shërbimeve;
- 3.6.2 Autoriteti dhe Konçesionari do të pranojnë amendimet e Anekseve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 18, 20, 21 dhe 25 dhe të ndonjë tjetër dispozite që lidhet me këtë Kontratë për të pasqyruar përfshirjen e Pullave Fiskale për zbatimin e këtyre produkteve shtesë brenda qëllimit të Shërbimeve;
- 3.6.3 të gjitha pëlqimet, lejimet dhe autorizimet e tjera që kërkohen sipas ligjeve shqiptare për implementimin e Pullave Fiskale për zbatimin ndaj këtyre produkteve shtesë, do të jepen ose sigurohen;
- 3.6.4 të gjitha rregulloret për të ardhurat përkatëse dhe/ose urdhrat (te cilat do të (a) përfshijnë kërkesat për Prodhuesit dhe Importuesit e këtyre produkteve shtesë për (i) të përdorur Pullat Fiskale për këto produkte, (ii) për tu pajtuar me kërkesat e Sistemit, duke përfshirë të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm me Autoritetin dhe Konçesionarin (duke përfshirë, pa kufizim, parashikimin dhe procedurat sic përcaktohen në Aneksin 25), dhe (iii) për t'i ofruar Konçesionarit akses të sigurt në ambjentet e tyre dhe në linjat e tyre të prodhimit për të instaluar pajisjet përkatëse dhe (b) për t'i treguar burimin prej nga do të kryhen pagesat për komisione tek Konçesionari) do të miratohen dhe do të jenë në fuqi; dhe
- 3.6.5 marrëveshjet e pranueshme nga Konçesionari të ngjashme me ato të paraqitura në pjesën 2 të Aneksit 8 do të bëhen në lidhje me Prodhuesit dhe Importuesit e këtyre produkteve shtesë.
- 3.7 Nëse, njëra Palë Kryesore propozon një amendim sipas Nenit 3.6, Pala tjetër Kryesore do të hyjë në bisedime me qëllim implementimin e këtij propozimi Brenda një periudhe të pranueshme kohe.
- 3.8 Që nga, dhe duke përfshirë Datën e Zbatimit deri në, por duke pëjashtuar Datën Efektive, detyrimet e Konçesionarit si më poshtë do të jenë detyrime të "Mëmës". Në dhe pas Datës Efektive detyrimet e Konçesionarit si më poshtë do të jenë detyrimet e

SICPA Albania dhe “Mëma” nuk do të mbajë përgjegjësi në lidhje me detyrimin e Konçesionarit që del në ose pas Datës Efektive

4. Data Efektive e Kontratës

4.1 Data Efektive e kësaj Kontrate do të jetë data në të cilën përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

4.1.1 ka ndodhur Data e Zbatimit dhe në këtë datë Konçesionari (ose ndonjë prej shoqërive të kontrolluara të tij, në emër të Konçesionarit) do të ketë mundësuar ose shkaktuar që Banka të ofrojë Garancinë e Zbatimit ndaj Autoritetit në përputhje me Nenin 53;

4.1.2 Këshilli i Ministrave do të lëshojë vendimin e tij për aprovimin e kësaj Kontrate dhe ky vendim duhet të hyjë në fuqi;

4.1.3 Autoriteti duhet t'i paraqesë këtë Kontratë Parlamentit të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë propozuar amendamente sipas legjislacionit shqiptar që janë të nevojshme për të bërë të efektshme të gjitha dispozitat e kësaj Kontrate;

4.1.4 Kjo Kontratë duhet të ratifikohet nga Asambleja e Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha ndryshimet sipas legjislacionit shqiptar që propozohen sipas Nenit 4.1.3 duhet të miratohen rregullisht dhe të marrin efekt përvesh atyre amendamenteve që nuk ndikojnë në implementimin e Projektit të Konçesionarit;

4.1.5 të gjitha rregulloret për të ardhurat përkatëse dhe/ose urdhrat e pranuar para Datës së Zbatimit ndërmjet Palëve (te cilat do të (a) përfshijnë kërkesat për Prodhuesit e Produkteve për (i) të përdorur Pullat Fiskale për këto produkte, (ii) pajtohen me kërkesat e Sistemit, duke përfshirë të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm me Autoritetin, dhe Konçesionarin (duke përfshirë, pa kufizim, planifikimin, kryerjen e pagesave që përcaktohen në Aneksin 25), dhe (iii) pajisin Konçesionarin me akses të sigurt në ambientet e tyre dhe në linjat e tyre të prodhimit për të instaluar pajisjet përkatëse dhe (b) tregojnë burimin prej nga do të kryhen pagesat për komisione tek Konçesionari) do të miratohen dhe do të jenë në fuqi; dhe

4.2 Autoriteti do të bëjë përpjekjet maksimale për të siguruar që kushtet e paraqitura në Nenet 4.1.2 deri 4.1.5 të përmbushen sa më shpejt të jetë e mundur, pasi kushti i paraqitur në Nenin 4.1.1 të jetë përmbushur. Autoriteti dhe Konçesionari bashkërisht do të bëjnë përpjekjet maksimale për të mundësuar që kushti i paraqitur në Nenin 4.1.5 të jetë përmbushur sa më shpejt të jetë e mundur pasi të jetë përmbushur kushti i paraqitur në Nenin 4.1.1. Nëse nuk ka ndodhur Data Efektive, në ose para datës, që është njëqind e tetëdhjetë ditë (180) pas datës kur kushti i paraqitur në Nenin 4.1.1 të jetë përmbushur.

- 4.2.1 nëse kjo mospërmbushje do të rezultojë në ndonjë shkelje nga Konçesionari të detyrimeve të tij të deklaruara sipas kësaj Kontrate, Autoriteti ka të drejtë (por nuk është i detyruar) të zgjidhë Kontratën duke i dërguar Konçesionarit një Njoftim për Zgjidhje; ose
- 4.2.2 nëse kjo mospërmbushje është rezultat i ndonjë shkelje nga AUtoriteti të detyrimeve të tij të deklaruara sipas kësaj Kontrate, Koncesionieri ka të drejtë (por nuk është i detyruar) të zgjidhë Kontratën duke i dërguar Autoritetit një Njoftim për Zgjidhje;

me kusht që, asnjë Palë Kryesore të mos ketë të drejtë të dërgojë një Njoftim për Zgjidhje sipas Nenit 4.2 në ose pas Datës Efektive. Pas dërgimit të një Njoftimi për Zgjidhje, Palët në këtë Kontratë nuk do të kenë më të drejta ose detyrime të mëtejshme sipas Kontratës (përveç këtyre të drejtave dhe detyrimeve, që sipas kushteve të deklaruara i mbijetojnë zgjidhjes së kësaj Kontrate)..

5. Plani i Zbatimit dhe Dizajni

- 5.1 Konçesionari do të ofrojë Shërbimet e Implementimit në përputhje me Planin e Zbatimit të paraqitur në Aneksin 10. Të gjitha Ndryshimet e Planit të Zbatimit do të nënshtrohen Procedurës së Ndryshimit të Kontrollit.
- 5.2 Dizenjimi i Pullave Fiskale, duke përfshirë elementët e sigurisë, paraqitet në Aneksin 4.

6. Testimi

- 6.1 Konçesionari duhet të njoftojë Autoritetin për datën në të cilën cdo linjë përpunimi e identifikuar në Aneksin 14 do të testohet në përputhje me Aneksin 6 jo më vonë se 3 Ditë Pune para kësaj date. Autoriteti do të përcaktojë një ose më shumë përfaqësues të Autoritetit të jenë të pranishëm gjatë kryerjes së të gjitha testeve të bëra sipas Aneksit 6; me kusht që prania ose mungesa e këtij përfaqësuesi ose përfaqësuesve të mos ndikojë në vlefshmërinë e ktyre testeve ose rezultateve për asnjë qëllim, sipas kësaj Kontrate.
- 6.2 Konçesionari do të paguaje të gjitha kostot dhe shpenzimet që lidhen me Pajisjet e Konçesionarit që janë objekt i ose përdoren në lidhje me Procedurat e Testimit dhe të gjithë Stafin e Konçesionarit në Procedurat e Testimit.
- 6.3 Nëse Konçesionari kalon në mënyrë të sukseshme një Test të kërkuar, sipas secilës prej Linjave Fillestare të Përpunimit, Autoriteti do t'i japë një Certifikatë për Arritje në Instalimin e Linjës në përputhje me Aneksin 6.

- 6.4 Autoriteti do t'i japë Konçesionarit Certifikatën e Arritjes së Objektivave, në përputhje me Aneksin 6.
- 6.5 Me lëshimin e të gjitha Certifikatave të Arritjes së Objektivave të percaktuara në Aneksin 6, Autoriteti do t'i japë Konçesionarit një Certifikatë Përfundimtare Pranimit në përputhje me Aneksin 6 (me kusht që kjo Certifikatë Përfundimtare Pranimit të lëshohet gjithashtu, nëse për ndonjë arsye për shkak të mospërbushjes nga Prodhuesit e Rangut të Lartë, një ose më shumë Certifikata për Arritjen e Instalimit të Linjës, nuk mund të jepeshin). Pavarësisht lëshimit të ndonjë Certifikate për Arritjen e Objektivave ose Certifikate Përfundimtare të Pranimit, Konçesionari do të mbajë përgjegjësi vetëm për të mundësuar që Zgjidhja, sipas dizenjimit dhe zhvillimit, është e përshtatshme për shpërndarjen e Shërbimeve, për të mundësuar që Shërbimet janë implementuar në përputhje me Kërkesat dhe kushtet e tjera të kësaj Kontrate për të mundësuar që Nivelet e Shërbimit të jenë Arritur. Asnjë heqje-dorë nga të drejtat nuk do të nenkuptohet nga lëshimi i një Certifikate për Arritjen e Objektivave.

7. Vonesat në Zbatim- Dispozita të Përgjithshme

- 7.1 Nëse në çdo kohë, Konçesionari ka dijeni se ai nuk do të (ose mund të mos) Arrij ndonjë Objektiv në Datat e Objektivit, ai do të njoftojë menjëherë Autoritetin për këtë Vonesë dhe do të përmbledh arsyet.
- 7.2 Sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se dhjetë (10) Ditë Pune pas marrjes së një njoftimi sipas Nenit 7.1, Konçesionari do t'i japë Autoritetit detaje me shkrim për:
- 7.2.1 Arsyet për Vonesën;
- 7.2.2 Pasojat e Vonesës; dhe
- 7.2.3 Nëse Konçesionari pretendon se Vonesa është shkaktuar nga një (a) Shkelje e Autoritetit ose (b) ndonjë veprim ose lenie jashtë e një Prodhuesi të Rangut të Lartë ose Importuesi Produktesh, çdo justifikim për këtë pretendim.
- 7.3 Nëse një Vonesë ka ndodhur për shkak të një Shkelje nga Autoriteti, Konçesionari do të përdorë të gjitha burimet shtesë dhe do të marrë të gjitha hapat e nevojshme për të lehtësuar ose shmangur pasojat e Vonesës. Autoriteti do të rimbursojë Konçesionarin për çdo shpenzim të arsyeshëm dhe të nevojshëm të shkaktuar nga Konçesionari gjatë përdorimit të këtyre burimeve dhe ndërmarrjes së këtyre hapave nëse:
- 7.3.1 Autoriteti jep aprovim paraprak me shkrim të këtyre shpenzimeve, ky aprovim nuk duhet të mbahet pa-shkak; ose

- 7.3.2 Pasoja e shmangura ose të lehtësuara të Vonesës ishin të një natyre dhe rëndësie të menjëhershme që e bënë Koncesionarin të kryejë këto shpenzime menjëherë dhe pa marrë miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit.
- 7.4 Cdo lloj konflikti që lidhet me ose si pasojë e Vonesave do të zgjidhet përmes Procedurës së Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve.. Në pritje të zgjidhjes së konfliktit, Palët Kryesore do të vazhdojnë të punojnë për të zgjidhur shkaqet e, dhe të lehtësojnë efektet e Vonesës.
- 7.5 Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit një Plan Korrigjimi nëse:
- 7.5.1 Ai ka dijeni se nuk do të marrë një Objektiv ne Daten e Objektivit; ose
- 7.5.2 Përpjekjet e tij për të Arrije një Objektiv ne Daten e Objektivit kanë dështuar për shkak të:
- (a) Ndonjë prej Shërbimeve ose Pullave Fiskale që lidhen me atë Objektivqë nuk i është paraqitur Autoritetit;
 - (b) Dështimin e një Testi të kërkuar në lidhje me atë Objektiv; ose
 - (c) Aty ku nuk kërkohen Teste në lidhje me atë Objektiv, cdo mospërputhje e Shërbimeve ose Pullave Fiskale në lidhje me atë Objektiv.
- 7.6 Drafti i Planeve të Korrigjimit do të identifikojë të gjitha çështjet që dalin në lidhje me Vonesën përkatëse dhe masat që Koncesionari do të marrë për të Arritur një Objektiv.
- 7.7 Drafti i Planeve të Korrigjimit duhet t'i dërgohet Autoritetit për aprovim sa më shpejt të jetë e mundur dhe në cdo rast jo më vonë se dhjetë (10) Ditë Pune (ose ndonjë tjetër periudhë të tillë të miratuar nga Autoriteti dhe Koncesionari me shkrim) pas lëshimit të:
- 7.7.1 Një njoftimi në lidhje me Nenin 7.1; ose
- 7.7.2 Një Raporti në Mospërmbushje.
- 7.8 Autoriteti nuk do të mbajë pa shkak aprovimin e tij për draftin e Planit të Korrigjimit. Nëse Autoriteti nuk aprofon draftin e Planit të Korrigjimit ai duhet të njoftojë Koncesionarin për arsyet e tij dhe Koncesionari do të marrë në konsideratë këto arsye në përgatitjen e mëtejshme të draftit të Planit Korrigjues, që do t'i ri-paraqitet Autoritetit Brenda dhjetë (10) Ditëve Pune nga data e refuzimit të parë të draftit.

7.9 Konçesionari do të veprojë në përputhje me cdo Plan Korrigjimi sipas aprovimit të tij nga Autoriteti.

8. Vonesat për shkak të Mospërmbushjes së Konçesionarit

8.1 Nëse Sistemi nuk merr ndonjë Objektiv për shkak të Mospërmbushjes së Konçesionarit, Autoriteti do t'i dërgojë një Raport për Mospërmbushje Konçesionarit duke parashtruar Cështjet e Testimit të gjetura ose në rast të mos kryerjes së testimit, atëherë duke specifikuar mënyrën e mosfunksionimit të Sistemit sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate, duke përfshirë ndonjë arsye tjetër për dështimin për të Arritur Objektivin dhe konsekuencat vijuese për ndonjë Objektiv tjetër.

8.2 Pasi të ketë lëshuar një Raport për Mospërmbushje në përputhje me Nenin 8.1, Autoriteti nën kompetencën e tij mund të:

8.2.1 Japë një Certifikatë për Arritje Objektivit në varësi të ndreqjes së Cështjes së Testit ose mospërmbushjes, sipas një Plani Korrigjimi të rënë dakord; dhe/ose

8.2.2 Nëse Cështja e Testit ose mospërmbushja është një Cështje Materiale Testimi, do të refuzojë të japë një Certifikatë për Arritjen e Objektivave të kushtëzuar sic paraqitet në Nenin 8.2.1 dhe ti referohet lëshimit të një Procesi Përshpejtimi dhe nëse cështja nuk mund të zgjidhet të zbatojë ndonjë nga të drejtat që ka sipas Nenit 49; dhe/ose

8.2.3 Të kërkojë dhe të Vonojë Pagesat që janë për tu paguar nga Konçesionari sipas Aneksit 11. Nëse nuk ka Pagesa të Vonuara sipas Aneksit 11 në lidhje me Objektivin perkates, Autoriteti rezervon të drejtën e tij dhe ndonjë mjet tjetër me që ofrohet nga kjo Kontratë ose nga Ligji

8.3 Nëse Autoriteti lëshon Certifikatë për Arritjen e Objektivit të kushtëzuar ashtu si në Nenin 8.2.1, ai mund të zgjedhë (por nuk është i detyruar ta bëjë këtë) të rishikojë Datën e Mospërmbushjes së Objektivit dhe cdo date të vazhdueshme Objektivit.

8.4 Pagesa e ndonjë Pagese të Vonuar nga ose në emër të Konçesionarit nuk do ta cliroje Konçesionarin prej detyrimit për të përfutur Certifikatë për Arritjen e Objektivave, konform Planit të Zbatimit ose konform ndonjë Plani Korrigjimi të pranuar, ose nga ndonjë detyrim ose përgjegjësi tjetër sipas kësaj Kontrate. Kjo Kontratë nuk do të ndalojë Autoritetin nga (a) zbatimi i ndonjë prej të drejtave të tij sipas kësaj Kontrate, dhe (b) sipas Nenit 43, të kërkojë dëme të përgjithshme nëse Konçesionari vazhdon të dështojë në sigurimin e ndonjë Certifikate për Arritjen e Objektivave.

9. Vonesat në Arritjen e Objektivave për shkak të Autoritetit, Prodhuesve ose Importuesve

- 9.1 Pa çenuar Nenin 7.3 dhe sipas Nenit 7.4, nëse Koncesionari do të kishte Arritur një Objektiv në Datën e Objektivit, por nuk pati sukses për ta bërë këtë për shkak të (a) një Shkelje të Autoritetit, atëherë, sipas njoftimit me shkrim që Koncesionari i dërgon Autoritetit për këtë Shkelje të Autoritetit, dhe nevojës për ndonjë lehtësim brenda 30 Ditëve Pune nga data e atij njoftimi, Koncesionari do të ketë të drejtat dhe lehtësitë e Nenit 9, ose (b) një veprimi material ose heqjes së Produkteve të një Prodhuesi të Rangut të Lartë, Koncesionari nuk do të jetë në Shkelje të kësaj Kontrate si rezultat i këtij mosfunksionimi ose ndonjë Vonesë që lidhet me të. Palët Kryesore në këtë rast do të marrin të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar përputhshmëri të plotë dhe të menjëherëshme në përputhje me Prodhuesit e Rangut të Lartë.
- 9.2 Nëse Autoriteti, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, vendos se dështimi i Koncesionarit për të Arritur një Objektiv është rezultat i një Shkelje nga ana e Autoritetit atëherë Koncesionarit:
- 9.2.1 duhet t'i jepet një zgjatje e Datës së Objektivit në përputhje me Nenin 9.3;
- 9.2.2 nuk do të konsiderohet të ketë kryer një Shkelje sipas kësaj Kontrate, për shkak të dështimit të tij në Arritjen e Objektivit përkatës në Datën e Objektivit; dhe
- 9.2.3 nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë Vonesë në lidhje me Objektivin përkatës për shkak se kjo Vonesë rezulton nga kjo Shkelje e Autoritetit dhe nuk do t'i kërkohet të paguajë Pagesa Vonesë në lidhje me këtë Vonesë.
- 9.3 Autoriteti:
- 9.3.1 do ta konsiderojë kohëzgjatjen e Vonesës, natyrën e Shkeljes së Autoritetit dhe efektin e Vonesës dhe Shkeljen e Autoritetit në aftësinë e Koncesionarit për të zbatuar Planin e Implementimit;
- 9.3.2 do të konsultohet me Përfaqësuesin e Koncesionarit për të vendosur efektin e Vonesës dhe se si të reduktojë këtë efekt aty ku është i zbaueshëm;
- 9.3.3 do të caktojë një Datë të arsyeshme të rishikuar të Objektivit për përfundimin e Objektivit në fjalë, e cila do të ndodhë në një periudhë kohore pas Datës fillestare të Objektivit që nuk është më pak se periudha e Vonesës; dhe
- 9.3.4 nëse është e përshtatshme, do të bëjë cdo rishikim të rëndësishëm të mëvonshëm të Objektivave të mëvonshme të Planit të Zbatimit.

- 9.4 Datat e Objektivave dhe çdo Datë e Objektivave do të rishikohen rregullisht nga Palët Kryesore por përvec atyre të parashikuara në këtë Nen, ato nuk do të shtyhen vetëm nëse të dyja Palët Kryesore bien dakord me shkrim.
- 9.5 Cdo Ndryshim i kërkuar për Planin e Zbatimit sipas nenit 9 do të marrë efekt në përputhje me Procedurën për Ndryshimin e Kontrollit. Nëse analiza e Koncesionarit për pasojën e Vonesës sipas Nenit 9.3 lejon disa opsione, atëherë Autoriteti do të ketë të drejtë të zgjedhë në mënyrë të arsyeshme cilin opsion të zbatojë.
- 9.6 Autoriteti nuk do të vonojë pa shkak përcaktimin e efektit të një Vonesë sipas Nenit 9 ose kur pranon një Ndryshim sipas Procedurës për Ndryshimin e Kontrollit.
- 9.7 Koncesionari do të sigurojë që cdo Nënkontraktues të marrë dhe të vazhdojë të marrë të gjitha masat e arsyeshme për lehtësimin e humbjeve dhe/ose shpenzimeve që ai kryen si rezultat i një Shkelje të Autoritetit.
- 9.8 Cdo dështim nga Koncesionari për të Arritur një Objektiv si rezultat i një Shkelje të Autoritetit ose ndonjë veprimi material ose lënies jashtë të një Prodhuesi, nuk do të përbëjë bazën për zgjidhjen e kësaj Kontrate nga Koncesionari ose Autoriteti, dhe nuk do të rezultojë në detyrimet e Koncesionarit në lidhje me heqjen e atij Objektivit, dhe sipas Nenit 12 të drejtat dhe mjetet ligjore që parashikohen në Nenin 9 do të jetë vetëm në lirinë ekskluzive të Koncesionarit në lidhje me këtë Shkelje të Autoritetit.

10. Shërbimet

- 10.1 Sipas Nenit 17.4, Koncesionari do të ofrojë Shërbimet për të mundësuar që Shërbime të ofrohen në përputhje me:
- 10.1.1 Kërkesat e paraqitura në Aneksin 2;
- 10.1.2 Zgjidhjen e paraqitur në Aneksin 3;
- 10.1.3 cdo afat kohor i paraqitur në këtë Kontratë duke përfshirë ato në Planin e Zbatimit, Kërkesat dhe Zgjidhjen; dhe
- 10.1.4 të gjitha pjesët e tjera të kësaj Kontrate.
- 10.2 Pa cënuar Nenin 10.1, Koncesionari do të ofrojë cdo aspekt të Shërbimeve Operacionale nga Data e Pare, dhe sipas Nenit 11.
- 10.3 Koncesionieri do të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate duke përfshirë ato që lidhen me Shërbimet në përputhje me:

- 10.3.1 Ligjin;
- 10.3.2 Praktikën e Industrisë së Mirë;
- 10.3.3 Produktet e veta;
- 10.3.4 Politikën e Sigurisë;
- 10.3.5 Planet e Cilësisë; dhe
- 10.3.6 Të gjitha udhëzimet e arsyeshme që i jepen Konçesionarit nga Përfaqësuesi i Autoritetit gjatë Afatit, për aq sa këto udhëzime lidhen me Shërbimet dhe me kusht që këto udhëzime të jenë në përputhje me këtë Kontratë, duke iu nënshtruar të drejtës së Konçesionarit për të sfiduar këto udhëzime sit ë paarsueshme ose këto udhëzime janë object i Procedurës së Ndryshimit të Kontrollit.
- 10.4 Për aq sa Konçesionari ka diejti për të, ai do të sjellë në vëmendje të Autoritetit cdo kundërshti mes kërkesave të Nenit 10.1 dhe Nenit 10.3 dhe do të pranojë Ndryshimin për të zgjidhur konfliktin me Autoritetin. Aty ku ky Ndryshim bie ndesh me urdhrin e procedurës të përmendur në Nenin 1.5 të kësaj Kontrate, atëherë ai do të nënshtrohet Procedurës së Ndryshimit të Kontrollit.
- 10.5 Sipas Nenit 9.1, nëse Konçesionari nuk arrin të ofrojë Shërbimet ose të veprojë në përputhje me detyrimet e veta sipas kësaj Kontrate, Autoriteti mund, pa cënuar të drejtat e tjera të tij, t'i kërkojë Konçesionarit të ri-ofrojë Shërbimet ose të veprojë në përputhje me detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate.

11. Nivelet e Shërbimit dhe Nivelet e Krediteve

- 11.1 Koncesionieri do të mundësojë se cdo Aspekt i Shërbimeve Operacionale arrin ose kalon Nivelin e Shërbimit përkatës. Dispozitat e tjera të Nenit 11 i nënshtrohen dispozitave të Nenit 12.
- 11.2 Nëse ka një Mosfunksionim Kritik të Shërbimit ose Konçesionarit beson se do të ketë një Mosfunksionim Kritik të Shërbimit, Konçesionari do të:
 - 11.2.1 të njoftojë menjëherë Autoritetin për Mosfunksionimin e Shërbimit Kritik ose për një Mosfunksionim Kritik të mundshëm Shërbimi;
 - 11.2.2 t'i ofrojë Autoritetit një Plan Korrigjimi që tregon se veprimi që do të marrë do të korrigjojë Mosfunksionimin Kritik të Shërbimit ose për të parandaluar shkaktimin e

ndonjë Mosfunksioni të mundshëm Kritik të Shërbimit, Brenda dhjetë (10) Ditëve Pune nga data në të cilën Konçesionari njofton Autoritetin sipas Nenit 11.2.1;

- 11.2.3 të përdorë të gjitha burimet shtesë për të korrigjuar ose parandaluar shkaktimin e Mosfunksionimit Kritik të Shërbimit, ose të një Mosfunksionimi të mundshëm Kritik të Shërbimit ; dhe
- 11.2.4 të zbatojë Planin e pranuar të Korrigjimit sipas Nenit 11.2.2 në përputhje me kushtet e saj.
- 11.3 Konçesionari do t'i ofrojë Autoritetit jo më vonë se një muaj pas datës së fundit të cdo Viti të Kontratës, një raport duke përmbledhur Mosfunksionimet e Shërbimit dhe Mosfunksionimet Kritike të Shërbimit (nëse ka) që kanë ndodhur gjatë Vitit të Kontratës dhe të parastrojë Kredite e Shërbimit të përlogaritura në lidhje me këto Mosfunksionime të Shërbimit në Nenin 43.3.1, Tarifa e Koncesionit e pagueshme në lidhje me cdo Vit të Kontratës, do të rritet në përputhje me Aneksin 11, për të pasqyruar Kreditet e Shërbimit nëse ka, të përlogaritura në këtë Vit të Kontratës.

12. Pasojat e një Shkelje nga Autoriteti gjatë Periudhës Operacionale.

- 12.1 Nëse Konçesionari deshton në të ofrojë Shërbimet Operacionale në përputhje me Nivelet e Shërbimit dhe/ose këto Marrëveshje për shkak të një Shkelje të Autoritetit, atëherë:
- 12.1.1 Konçesionari do të trajtohet (në matjen e performancës të Shërbimit të prekur) sikur Shërbimi përket të këtyre arritur Nivelin e Shërbimit;
- 12.1.2 asnjë Shkelje nuk do të konstatohet për atë sa ky mosfunksionim shkaktohet nga një Shkelje e Autoritetit; dhe
- 12.1.3 Konçesionari ka të drejtë të rimbursohet nga Autoriteti për shpenzimet e tij të arsyeshme dhe shtesë të shkaktuara nga Shkeljet e Autoritetit nëse:
- (a) Këto shpenzime janë aprovuar me shkrim nga Autoriteti përpara se të kryeshin; ose
 - (b) Është e nevojshme të kryhen shpenzime të menjëhershme pa marrë miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit për të shmangur shpenzimet e mëtejshme, por edhe në këto raste Konçesionari përsëri do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të pranuar shpenzimet me Autoritetin, përpara se ti kryejë ato.

- 12.2 Nëse Konçesionari pretendon se cdo e drejtë ose detyrim sipas Nenit 12.1 gjen zbatim, ai do t'a pajisë Autoritetin me detajet e Shkeljes së Autoritetit.
- 12.3 Cdo mosmarrëveshje në lidhje me dështimin e Konçesionarit për të ofruar Shërbimet në lidhje me Nivelet e Shërbimit dhe/ose këtë KONtratë, është si rezultat i një Shkelje të Autoritetit do të zgjidhet përmes Procedurës së Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve. Në pritje të zgjidhjes së kësaj Shkeljeje, të dyja Palët Kryesore do të vazhdojnë të zgjidhin shkaku e, dhe të lehtësojnë efektet e këtij mosfunksionimi.

13. Standardet

Konçesionari do të pajtohet me Standardet e përmendura ose të referuara në Aneksin 20 sa më shpejt të jetë e mundur pas Datës Efektive, në përmbushje të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.

14. Sigurimi i Cilësisë dhe Monitorimi

14.1 Para Datës Efektive Koncesionari do të zhvillojë Planet e Cilësisë:

14.1.1 të mundësojë që të gjitha aspektet e Shërbimeve janë objekt i sistemeve të përshtatshme të menaxhimit të cilësisë; dhe

14.1.2 që janë në përputhje me ISO 9001 : 2000 ose ndonjë standard tjetër ekvivalent, që pranohet gjerësisht të ketë zëvendësuar këtë standard. Për më tepër, Konçesionari duhet të certifikohet me ISO 9001 : 2000 jo më vonë se data e përvjetorit të dytë pas Datës Efektive të kësaj Kontrate.

14.2 Konçesionari do të mundësojë që Shërbimet të zhvillohen në përputhje me Planet e Cilësisë nga Data Efektive.

14.3 Autoriteti mund të monitorojë performancën e Shërbimeve nga Konçesionari në përputhje me Kërkesat e paraqitura në Aneksin 2.

14.4 Konçesionari do të bashkëpunojë dhe do të mundësojë që të gjithë Nënkontraktorët të bashkëpunojnë me Autoritetin, pa tarifa shtesë, për të mundësuar zbatimin e monitorimit në Nenin 14.3.

14.5 Nëse Konçesionari mendon se monitorimi i Shërbimeve nga Autoriteti është i paarsyeshëm, Konçesionari mund të ngrijë shkallëzgjatje cështjen me Autoritetin duke përdorur Procedurën e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, sic paraqitet në Aneksin 15.

15. Përmirësimi i Shërbimit

- 15.1 Konçesionari do të ketë një detyrim të vazhdueshëm gjatë Afatit për të identifikuar përmirësimet e reja të mundshme të Shërbimeve. Si pjesë e këtij detyrimi, Konçesionari do të identifikojë dhe do t'i raportojë Bordit të Menaxhimit të Projektit cdo (12) muaj gjatë Afatit, duke filluar me përvjetorin e parë të Datës së Parë dhe të monitorojë dhe të këshillojë Autoritetin për:
- 15.1.1 Emergjencën e teknologjive të reja përkatëse të cilat mund të përmirësojnë Sistemin dhe/ose Shërbimet, dhe ato përparime teknologjike të mundshme për Konçesionarin dhe Autoritetin të cilat Palët Kryesore mund të dëshirojnë të miratojnë; dhe/ose
- 15.1.2 Përmirësime të reja ose të mundshme të Shërbimeve që mund të sigurojnë një përfitim material në lidhje me këto Shërbime; dhe
- 15.1.3 Ndryshimet në vecoritë e sigurisë dhe teknologjisë të zbatueshme për Pullat Fiskale;
- 15.2 Konçesionari do të marrë të gjitha masat për të mirëmbajtur dhe përditësuar Sistemin për të mundësuar që Sistemi të përfshijë praktikatat e të mira të industrisë për sisteme të ngjashme në masë dhe qëllim ndaj Sistemit, duke marrë në konsideratë volumin dhe vlerën e Produkteve ndaj të cilave do të aplikohen Pullat Fiskale. Në lidhje me përditësimin e Sistemit, zbatohet Aneksi 27.
- 15.3 Për aq sa Konçesionari pranon të zbatojë përmirësime të reja ose të mundshme ndaj Sistemit, të identifikuara sipas Nenit 15, dhe këto përmirësime kërkojnë Ndryshime të kësaj Kontrate, Palët Kryesore do të përdorin Procedurën e Ndryshimit të Kontrollit për të zbatuar këto Ndryshime.

16. Sistemi

- 16.1 Vetëm nëse pranohet me shkrim nga Autoriteti ose përcaktohet ndryshe në këtë Kontratë, Konçesionari do të përdorë Sistemin vetëm për ofrimin e Shërbimeve ndaj Autoritetit dhe nuk do ta përdorë atë për qëllimet personale të Konçesionarit ose për t'i ofruar Shërbime të tjera palëve të treta.
- 16.2 Asetet e Konçesionarit që ndodhën në Objektin Qëndror të Prodhimit do të jenë në rrezikun dhe përgjegjësinë e Konçesionarit, sipas Nenit 38.
- 16.3 Objekt i ndonjë dispozite të shprehur në këtë Kontratë për të kundërtën, humbja ose shkatërrimi për ndonjë asset të Konçesionarit në vendndodhje, nuk do të shkarkojë Konçesionarin nga detyrimet e tij për të ofruar Shërbime në përputhje me Nivelet e Shërbimeve..

17. Vendosja e Cmimeve dhe Cështjet Financiare

- 17.1 Cmimi për Njësi i prodhuar dhe i shpërndarë nga Konçesionari (i përjashtuar nga (a) TVSH dhe (b) ndonjë Taksë tjetër ose taksë e pullës sipas ligjit Shqiptar) do të jetë si në tabelën e paraqitur më poshtë:

<u>Produkti</u>	<u>Lloji i Pullës Fiskale</u>	<u>Cmimi për Mijë (në €, përjashtuar nga TVSH dhe Taksë të tjera)</u>
Duhan	Pulle e Sigurisë	€20.00
Alkol	Pulle e Sigurisë	€32.00
Birra	Kodi i Sigurisë	€22.00
Farmaceutika	Pulle e Sigurisë	€14.43
Produkte Shtesë	Të përcaktuara sipas Nenit 3.6	Të përcaktuara në përputhje me Nenin 3.6

- Për aq sa cdo shumë e TVSH ose Taskave të tjera janë të pagueshme në lidhje me cdo Njësi të prodhuar dhe të shpërndarë nga Konçesionari, kjo shumë do të jetë për llogari të Prodhuesit ose Importuesit që blen Njësinë, sic paraqitet në Nenin 18.
- 17.2 Konçesionari do t'i paguajë Autoritetit Tarifën e Koncesionit sipas kushteve dhe afateve të paraqitura në Aneksin 18.
- 17.3 Autoriteti do të udhëzojë të gjithë Prodhuesit dhe Importuesit e Produkteve të kryejnë të gjitha pagesat që ata detyrohen, sipas Aneksit 25 në lidhje me Pullat Fiskale, direkt Konçesionarit, dhe Autoriteti do të mundësojë që të gjitha rregullat lejuese ose legjisacionin e kërkuar në lidhje me kryerjen e këtyre pagesave të jetë në fuqi dhe të ketë efekt gjatë Afatit. Faturimi dhe pagesat në lidhje me Shërbimet do të përmbushën sipas Aneksit 25.
- 17.4 Konçesionarit nuk i kërkohet ose lejohet t'i dërgojë Pullat Fiskale një Prodhuesi vetëm nëse këto Pulla Fiskale janë parapaguar plotësisht nga Prodhuesi; me kusht që Konçesionarit t'i lejohet, por nuk do të jete i detyruar t'i dërgojë Pullat Fiskale një Prodhuesi, pavarësisht se këto Pulla Fiskale nuk janë parapaguar plotësisht nga Prodhuesi, nëse Konçesionari ka marrë lejim paraprak me shkrim nga Autoriteti për të dërguar këto Pulla Fiskale. Konçesionari nuk mban përgjegjësi për dëmet direkte ose indirekte të shkaktuara nga Autoriteti, ndonjë Përdorues Fundor ose ndonjë Prodhues si rezultat i ndonjë mos-dërgimi të Pullave Fiskale.

- 17.5 Palët Kryesore pranojnë të përmbushin të gjitha dispozitat e Aneksit 11 (duke përfshirë dispozitat në lidhje me Shërbimin e Krediteve dhe Pagesat e Vonuara), Aneksi 18 (duke përfshirë dispozitat në lidhje me Komisionet dhe Tarifat) dhe Aneksin 25.
- 17.6 Konçesionari do të përshtasë financimet e duhura (qoftë përmes financimit të borxhit ose pjesëmarrjes në kapital për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Kontratës, por nuk do të ngarkojë, pengojë ose të vendosë një barrë në Sistem, në Sistemin Qëndror të Monitorimit të Gjurmëve, ose ndonjë aset tjetër të përdorur për ofrimin e Shërbimeve dhe këtyre sistemeve ose njësive.
- 17.7 Vetëm nëse parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë KONtratë, AUtoriteti nuk do të ketë detyrim të kryejë ndonjë kontribut (financiar ose tjetër) në lidhje me këtë Koncesion.
- 17.8 Nëse, gjatë cdo Viti të Kontratës, Autoriteti i kërkon Konçesionarit të ofrojë më shumë se 200 Njësi Kompjuterike, Autoriteti pranon t'i paguajë Konçesionarit një komision për qira vjetore të 2,500 EURO për cdo Njësi Kompjuteri Shtesë, përveç 200 Njësive Kompjuterike të ofruara gjatë Vitit të Kontratës.
- 17.9 Me kërkesën e Autoritetit, Konçesionari gjatë Afatit duhet të kryejë një analizë laboratorike, vetëm për qëllime mjeko-ligjore, për të përcaktuar nëse produktet e identifikuar nga Autoriteti janë Produkte të, dhe të paraqesë një raport me shkrim nëse është e nevojshme (secili një "**Raport Kriminalistik**"). Nëse Autoriteti i kërkon Konçesionarit të lëshojë më tepër se dymbëdhjetë Raporte Kriminalistike në cdo Vit të Kontratës, Autoriteti pranon t'i paguajë Konçesionarit tarifën e Raportit Teknik për cdo Raport Kriminalistik të lëshuar në Vitin e Kontratës që tejkalon dymbëdhjetë te tilla, që do të kete një tarifë prej 12,850 EUR për cdo Raport Kriminalistik ose sic pranohet reciprokisht ndërmjet Konçesionarit dhe Autoritetit përpara lëshimit të ndonjë Raporti Kriminalistik të tillë.

18. TVSH

Në lidhje me ndonjë pagesë që do t'i paguhet Konçesionarit sipas kësaj Kontrate ose e thënë ndryshe në përputhje me Aneksin 25 nga Autoriteti, ndonjë Prodhues ose Importues, pagues në lidhje me këtë pagesë do t'i paguajë Konçesionarit ose autoritetit tatimor përkatës, sipas rastit, shumën e cdo TVSH të ngarkuar në lidhje me artikullin ose artikujt me të cilat lidhet kjo pagesë.

19. Përfaqësuesit

- 19.1 Konçesionari do të emërojë Përfaqësuesin e Konçesionarit. Përfaqësuesi i Konçesionarit do të ketë kompetencë të veprjohë në emër të Konçesionarit për çështjet e paraqitura në, ose në lidhje me këtë Kontratë.
- 19.2 Autoriteti do të emërojë Përfaqësuesin e Autoritetit. Përfaqësuesi i Autoritetit do të ketë kompetencë të veprjohë në emër të Autoritetit për çështjet e paraqitura në, ose në lidhje me këtë Kontratë, sipas dispozitave drejtuese që paraqiten në Nenin 20 dhe në Aneksin 19.
- 19.3 Përfaqësuesi i Konçesionarit duhet të ketë eksperiencë të mjaftueshme në shoqërinë e Konçesionarit dhe duhet të ketë kompetenca të mjaftueshme për të siguruar bashkëpunimin e plotë nga Staf i Konçesionarit për detyrimet e Konçesionarit sipas kësaj Kontrate.
- 19.4 Autoriteti mund t'i kërkojë Konçesionarit të zëvendësojë Përfaqësuesin e Konçesionarit sipas Nenit 26.

20. Zbatueshmëria

Palët Kryesore pranojnë të administrojnë këtë Kontratë përmes dispozitave drejtuese të paraqitura në Aneksin 19 ose sipas miratimit të mëtejshëm me shkrim të Palëve Kryesore.

21. Nënkontraktimi

- 21.1 Konçesionari nuk do të delegojë ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit, i cili nuk duhet ta mbajë ose ta vonojë atë pa shkak. Ofruesit e pajisjeve, Software- dhe hardware nuk duhet të konsiderohen si Nënkontraktorë për qëllimet e kësaj Kontrate.
- 21.2 Sipas Nenit 21.3, me plotësimin e një kërkesë sipas Nenit 21.1, Konçesionari do t'i ofrojë Autoritetit cdo informacion në lidhje me Nënkontraktuesin që kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti.
- 21.3 Autoriteti ka miratuar angazhimin e Nënkontraktuesve të përmendur në Aneksin 9 sipas ofrimit nga Konçesionarit të informacionit të përmendur në Nenin 21.2 brenda njëzetë (20) Ditëve Pune pas Datës Efektive (ose ndonjë periudhe tejtër të miratuar nga Palët Kryesore).

22. Rishikimi i Shërbimit

Në cdo kohë gjatë Afatit secila prej Palëve Kryesore mund të hyjë në diskutime për të rishikuar Shërbimet dhe cdo Ndryshim i pranuar duhet të zbatohet përmes Procedurës për Ndryshimin e Kontrollit.

23. Auditimet financiare dhe të Cilësisë

23.1 Autoriteti ose përfaqësuesit e tij financiarë do të kenë të drejtë të kryejnë auditime të Konçesionarit, jo më shumë se dy herë gjatë cdo Viti të Kontratës; për të:

23.1.1 verifikuar saktësinë e përcaktimit të shumës së Tarifave të Koncesionit që i paguhen Autoritetit;

23.1.2 kontrolluar numrin e Pullave Fiskale të prodhuara dhe të shpërndara dhe që këto Pulla Fiskale të plotësojnë të gjitha kriteret e sigurisë të paraqitura tek Kërkesat dhe Politika e Sigurisë;

23.1.3 rishikuar vërtetësinë, konfidencialitetin dhe sigurinë e të Dhënave të Autoritetit;

23.1.4 rishikuar përputhshmërinë e Konçesionarit me detyrimet e tij sipas Neneve 10.1, 10.3 dhe 14 ;

23.1.5 kontrolluar dokumentet përkatës për të përcaktuar nëse Konçesionari ka implementuar rregullisht në këto dokumente ndonjë Ndryshim të miratuar nga Palët Kryesore sipas Procedurës për Kontrollin e Ndryshimit; dhe

23.1.6 të mundësojë përputhshmërinë me cdo detyrim tjetër të Konçesionarit sipas kësaj Kontrate.

23.2 Pavarësisht sa më sipër, qëllimi i një auditimi të kryer sipas Nenit 23 nuk do të përfshijë, dhe as Autoriteti ose dikush që vepron për ose në emër të Autoritetit nuk do të ketë akses tek ndonjë teknologji pronësie ose konfidenciale, njohuri teknike, Software-, ose ndonjë informacion në lidhje me çështje ligjore të parashikuara ndërmjet Palëve. Autoriteti nuk do të punësojë palë të treta në zbatimin e të drejtave të Autoritetit sipas Nenit 23.1 vetëm nëse kjo palë e tretë (a) është miratuar nga Konçesionari duke vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe (b) kjo palë e tretë ka hyrë në marrëveshje konfidencialiteti me Konçesionarin për termat që janë të pranueshme për Konçesionarin. Autoriteti do bëjë përpjekjet e arsyeshme për të mundësuar që cdo auditim të mos ndërpresë pa shkak Konçesionarin ose të vonojë ofrimin e Shërbimeve.

- 23.3 Sipas detyrimeve të konfidencialitetit të Autoritetit, Konçesionari do të pajisë menjëherë Autoritetin (dhe/ose agentët ose përfaqësuesit e tij) me gjithë bashkëpunimin dhe asistencën e arsyeshme në lidhje me cdo auditim, duke përfshirë:
- 23.3.1 të gjithë informacionin e arsyeshëm që kërkohet nga Autoriteti brenda qëllimit të lëjuar të kontrollit;
 - 23.3.2 aksesin e pranueshëm për cdo object të kontrolluar nga Konçesionari;
 - 23.3.3 aksesin e Sistemit, Sistemin Qëndror të Monitorimit të Gjurmimit dhe cdo Njësi Kompjuterike; dhe
 - 23.3.4 aksesin ndaj Stafit të Konçesionarit.
- 23.4 Konçesionari do të sigurojë sistemet e përshtatshme të matjes dhe monitorimit dhe procedurat për të prodhuar të dhëna të sakta, në kohë dhe të detajuara për të verifikuar ofrimin e Shërbimeve nga Konçesionari dhe përputhshmërinë me të gjitha Nivelet e zbatueshme të Shërbimeve.
- 23.5 Autoriteti do të përpiqet t'i (por nuk është i detyruar) sigurojë të paktën në pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune njoftim Konçesionarit ëpr qëllimin e tij për të kryer një auditim sipas Nenit 23.

Palët KRYEsore pranojnë të paguajnë kostot dhe shpenzimet përkatëse të shkaktuara në lidhje me përputhshmërinë me detyrimet e tyre sipas kësaj Kontrate.

- 23.7 Nëse auditimi tregon se Konçesionari nuk ka arritur të përmbushë të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, në cdo aspekt material, Palët Kryesore do të bien dakord dhe do të implementojnë një plan rregullues. Nëse dështimi i Konçesionarit lidhet me pamundësinë për të siguruar ndonjë informacion për Autoritetin për Komisionet ose shpenzimet e Konçesionarit, atëherë plani rregullator do të përfshijë një kërkesë për Konçesionarin për të ofruar të gjithë këtë informacion.

24. Regjistrat dhe Raportet

Palët Kryesore do të pajtohen me dispozitat e paraqitura në këtë Kontratë në lidhje me mbajtjen e të dhënave dhe raporteve duke përfshirë, por pavarësisht atyre të Kërkesave, Zgjidhjen dhe Aneksin 21. Konçesionari do t'i mundësojë këto të dhëna dhe raporte Autoritetit rregullisht sipas, formës, përmbajtjes dhe rregullores të përcaktuar nga Autoriteti.

25. Procedura e Kontrollit të Ndryshimit

- 25.1 Cdo kërkesë për Ndryshim do t'i nënshtrohet Procedurës për Kontrollin e Ndryshimit të paraqitur në Aneksin 16.
- 25.2 Nëse pas Datës së Ekzekutimit, ndonjë Ligj, rregullore, urdhëresë ose procedurë me kompetencën e një ligji në Republikën e Shqipërisë, hyn në fuqi, lëshohet ose amendohet dhe pengon Konçesionarin në përmbushjen e ndonjë prej kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate, këto terma dhe kushte do të përshtaten në përputhje me Procedurën për Kontrollin e Ndryshimit për të lejuar Konçesionarin të përmbushë këto detyrime.

26. Stafi

- 26.1 Cdo Palë Kryesore do të mundësojë që kjo Palë Kryesore të ketë stafin e mjaftueshëm për të përmbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Kontrate.

Konçesionari do të zëvendësojë menjëherë ndonjë punonjës i cili kryen veprime të paligjshme ose shkel materialisht përshkrimin dhe detyrimet e tij/saj të punës, në cdo rast për aq sa lidhet me zbatimin e detyrimeve të Konçesionarit sipas kësaj Kontrate, ose të cilin Autorteti e vlerëson sipas kompetencave të tij si kërcënim për sigurinë.

Secila prej Palëve Kryesore mund të kërkojë me shkrim që Pala tjetër Kryesore të përfundojë pjesëmarrjen në ofrimin e Shërbimeve ndaj cdo stafi të Palës tjetër Kryesore për arsye të tjera nga ato të kërcënimit të sigurisë. Pala tjetër Kryesore do të hetojë bazat e kërkesës së Palës Kryesore dhe do të njoftojë Palën Kryesore urdhëruese për masën (nëse ka) që kjo Palë tjetër Kryesore propozon të marrë në lidhje me këtë personel brenda tridhjetë (30) ditëve nga data që është përgatitur kjo kërkesë.

- 26.2 Konçesionari do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar vijimësinë e personelit dhe për të mundësuar që norma e ndryshimit të personelit të tij është në përputhje me nivelet standarde të industrisë për një Koncesioner që vepron sipas Praktikës së Industrisë së Mirë për shërbime të ngjashme, dhe rrethana si ato të përmendura në këtë Kontratë.
- 26.3 Palët Kryesore kanë rënë dakord me emërimin e Stafit Kryesor të listuar në një letër të vecantë dhe të pranuar nga Palët Kryesore. përmendur në një letër.
- 26.4 Konçesionari do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për tu konsultuar me Autoritetin në lidhje me zëvendësimin e ndonjë punonjësi të Stafit Kryesor, të paktën tre muaj para datës së propozuar për këtë zëvendësimi, duke iu nënshtuar rrethanave

të jashtëzakonshme në të cilat cdo zëvendësim i tillë duhet të bëhet në më pak kohë, si për shembull, vdekja, sëmundja, zgjidhja, amësia/atësia.

- 26.5 Konçesionari pranon se Personeli Kryesor është i rëndësishëm në ofrimin e përshtatshëm të Shërbimeve tek Autoriteti dhe do të mundësojë që cdo zëvendësim në Personelin Kryesor të jetë i cilësor dhe punëmarrësi të jetë i aftë të kryejë të gjitha detyrat e përcaktuara.
- 26.6 Konçesionari do të mundësojë që cdo punonjës i Stafit Kryesor të kryejë rregullisht funksionin e tij sipas Kontratës dhe sipas përcaktimit nga Konçesionari.
- 26.7 Konçesionari do të trajtojë personelin e Autoritetit në lidhje me proceset administrative dhe përdorimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e Sistemit sic paraqitet në Aneksin 17.

27. Ndryshimi i Kontrollit të Konçesionarit

- 27.1 Autoriteti mund të zgjidhë këtë Kontratë me anë të një njoftimi me shkrim pa penalitet nëse ka ndonjë Ndryshim të Kontrollit të Konçesionarit të cilin Autoriteti e kundërshton, përveç nëse Autoriteti ka dhënë miratimin e tij paraprak me shkrim për këtë Ndryshim të Kontrollit.
- 27.2 Konçesionari do të njoftojë Autoritetin me shkrim një (1) muaj para për cdo kryerjen e cdo Ndryshimi të propozuar të Kontrollit të Konçesionarit.
- 27.3 Në rast se Autoriteti zgjidh Kontratën për një rast të Ndryshim të Kontrollit sipas Nenit 27.1 kjo do të konsiderohet një Shkelje nga ana e Konçesionarit.

28. Ndryshim Tjetër Aksionar i Konçesionarit

- 28.1 Sipas Nenit 28.2, Autoriteti mund të zgjidhë këtë Kontratë pa penalitet në rast se në cdo kohë, ndonjë prej aksioneve të Konçesionarit mbahet direkt nga një aksioner (pavarësisht nëse kjo pronësi nuk përbën një Ndryshim të Kontrollit) që:
 - 28.1.1 është në konflikt interesi (p.sh., është një Prodhues ose Importues;
 - 28.1.2 nuk gëzon reputacion ose gjëndje financiare të mirë,
 - 28.1.3 është dënuar nga një gjykatë me juridiksionin përkatës për ndonjë shkelje që përbën mashtrim ose vepër penale; ose

28.1.4 është një shoqëri shtetërore në pronësi të ndonjë qeverie, e ndryshme nga qeveria e Republikës së Shqipërisë).

28.2 Konçesionari do të njoftojë menjëherë Autoritetin për cdo ndryshim në aksionet e Konçesionert që nuk përbën një Ndryshim të Kontrollit. Nëse Autoriteti në mënyrë të arsyeshme vendos se cdo ndryshim i tillë aksionar, përbën një shkelje të Nenit 28.1, Autoriteti do të njoftojë Konçesionarin për këtë vendim me shkrim, jo më vonë se 1 muaj pas datës në të cilën Konçesionari njofton Autoritetin për këtë ndryshim aksionar, dhe Konçesionari do të ketë të drejtë të riparojë këtë shkelje duke detyruar aksionarin përkatës t'i shesë aksionet e tij Konçesionarit jo më vonë se një muaj pas datës në të cilën Autoriteti njofton Konçesionarin për këtë vendim. Nëse ky aksioner shet këto aksione brenda kësaj periudhe një-mujore, Autoriteti nuk do të ketë të drejtë të përfundojë këtë Kontratë sipas Nenit 28.1.

28.3 Në rast se Autoriteti zgjidh këtë Kontratë sipas Nenit 28.1 për një ndryshim të aksionev, kjo do të konsiderohet si SHkelje nga Konçesionari.

29. Shëndeti dhe Siguria

Konçesionari pranon të veprojë në pëputhje me Ligjin në lidhje me shëndetin dhe sigurinë.

30. Barazia dhe Diversiteti

Konçesionari do të mundësojë që stafi i tij të veprojë në koherencë me të gjitha ligjet kunder-diskriminimit që janë në fuqi gjatë Afatit.

31. Të Drejtat e pronësisë Intelektuale

31.1 Kjo Kontratë nuk përcakton ndonjë të Drejtë të Pronësisë Intelektuale të ndonjë Pale ose të licensuesve të Palëve dhe, pa kufizuar përgjithësinë e sa më sipër, vetëm nëse përcaktohet ndryshe shprehimisht në këtë Kontratë;

31.1.1 Authority nuk do të marrë ndonjë të drejtë, titull ose interes në, ose sipas (a) të Drejtës së Pronësisë Intelektuale në pronësi të Konçesionarit ose (b) Programit të Palës së Tretë; dhe

31.1.2 Konçesionari nuk do të marrë ndonjë të drejtë, titull ose interes në, ose sipas ndonjë të Drejte për Pronësinë Intelektuale në pronësi të Autoritetit;

Me kusht që Autoriteti të zotërojë dizenjimet e Pullave Fiskale, të dhënat që lidhen me Pullat Fiskale dhe ndonjë administrim të informacionit ose raporteve nga Koncesionari sipas kësaj Kontrate.

32. Zbatimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Autoriteti pranon se në bashkëpunim me Institucione të tjera Shtetërore ai do të zbatojë Ligjin duke kërkuar që të gjitha Produktet ti nënshtrohen dhe të paraqesin një Pullë Fiskale me qëllim që Prodhuesit të mos shesin në Republikën e Shqipërisë gjatë Afatit të Produkteve që nuk kanë Pulla Fiskale. Autoriteti dhe Institucione të tjera Shtetërore do të punësojnë inspektorë të mjaftueshëm dhe nëpunës zbatimi për të zbatuar Ligjin duke kërkuar që të gjitha Produktet t'i nënshtrohen dhe të kenë Pullat Fiskale.

Koncesionari do të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë me anë të një Njoftimi për Zgjidhje brenda 12 muajve, në rast se Autoriteti dhe Institucione të tjera Shtetërore nuk përmbushin detyrimet sipas Nenit 32 dhe në rast se numri i Njësive të shpërndara nga Koncesionari gjatë periudhës 12 mujore, është më pak se 50% e numrave të mëposhtëm të Pullave Fiskale: 200 milion Pulla Fiskale për Produktet e Duhanit, 40 million Pulla Fiskale për Produktet Farmaceutike, 7 milion Pulla Fiskale për Produktet e alkolit, dhe 140 milion Pulla Fiskale për Produktet e birrës.

33. Licencat e lëshuara nga Autoriteti

33.1 Autoriteti në këtë mënyrë i jep Koncesionarit një licencë të revokueshme, jo-ekskluzive, të lirë nga taksat, gjatë Afatit, vetëm për atë që Autoriteti e cmon të nevojshme për ofrimin e Shërbimeve, për të përdorur dokumentacionin e Autoritetit, proceset dhe procedurat dhe të Dhënat e Autoritetit.

33.2 Licenca e dhënë Koncesionarit në Nenin 33.1:

33.2.1 përfshin të drejtën për të dhënë nënlicensa Nënkontraktuesve, për kushte jo më të favorshme se licenca e dhënë Koncesionarit sipas Nenit 33.1, me kusht që cdo Nënkontraktues përkatës të jetë miratuar nga Autoriteti sipas Nenit 21.1 dhe të ketë lidhur një sipërmarrje konfidencialiteti me Koncesionarin, kryesisht me të njëjtat kushte si ato të paraqitura në Nenin 42; dhe

33.2.2 do të jepet vetëm për atë që është e nevojshme për ofrimin e Shërbimeve sipas kësaj Kontrate. Koncesionari nuk do të, dhe do të mundësojë që Nënkontraktuesit të mos, përdorin materialet e licensuara që përmenden në Nenin 33.1 për ndonjë qëllim tjetër ose në dobi të ndonjë personi të ndryshëm nga Autoriteti.

- 33.3 Asnjë Palë Kryesore nuk ka të drejtë të përdorë ndonjë nga emrat e Palës tjetër Kryesore, logon ose market tregtare në asnjë prej produkteve ose shërbimeve të saj, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër Kryesore, përvec Pullave Fiskale.
- 33.4 Në rast të zgjidhjes ose mbarimit të afatit të kësaj Kontrate, licenca e përmendur në Nenin 33.1 dhe cdo nën-licensë e lëshuar sipas Nenit 33.2 do të përfundojë automatikisht dhe Koncesionari do t'i dërgojë menjëherë Autoritetit të gjithë materialin e licensuar për Koncesionarin ose Nënkontraktuesve të tij sipas Neneve 33.1 dhe 33.2 në zotërim të Koncesionarit ose Nënkontraktuesve, ose sipas opinionit të Autoritetit, do të shkatërojë këto materiale të licensuara sipas udhëzimeve të Autoritetit në atë kohë, ky shkatërrim duhet t'i vërtetohet me shkrim nga Përfaqësuesi i Koncesionarit, Autoritetit menjëherë pasi është kryer.

34. Detyrime të Caktuara të Mëmës

Mëma do të sigurojë që të gjitha objektet tregtare të SICPA Albania të ndryshoehn me qëllim që ato të lidhen vetëm me objektiviin e kësaj Kontrate.

35. Të Dhënat e Autoritetit

- 35.1 Koncesionari as nuk do të fshijë ose të heqë ndonjë njoftim pronësie që lidhet me të Dhënat e Autoritetit.
- 35.2 Koncesionari nuk do të depozitojë, kopjojë, shpërndajë ose përdorë të Dhënat e Autoritetit vetëm atëherë kur nevojiten për përmbushjen nga Koncesionari të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate gjatë Afatit ose kur shprehimisht vendoset me shkrim ndryshe nga Autoriteti.
- 35.3 Për aq sa të Dhënat e Autoritetit janë mbajtur dhe/ose përpunuar nga Koncesionari, Koncesionari do t'i japë këto të Dhëna të Autoritetit, Autoritetit dhe/ose ndonjë autoriteti tjetër rregullator, i cili është i autorizuar sipas Ligjit, sic kërkohet nga Autoriteti në formatin e paraqitur tek Kërkesat, Zgjidhja ose Aneksi 22.
- 35.4 Koncesionari do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur integritetin dhe për të parandaluar ndonjë korrupsion ose humbje, të ndonjë të Dhëne të Autoritetit në zotërim të Koncesionarit, duke përfshirë krijimin dhe depozitim jashtë objektit të 'back-up'-eve të sigurisë së këtyre të Dhënave të Autoritetit. Koncesionari do të mundësojë që të këto back-up t'i vihen në dispozicion Autoritetit në cdo kohë sipas kërkesës dhe t'i shpërndarhen Autoritetit jo më pak se një herë në cdo dy (2) muaj.
- 35.5 Nëse të Dhënat e Autoritetit në zotërim të Koncesionarit janë të korrupsuara, kanë humbur ose janë pakësuar si pasojë e Mospërmbushjes së Koncesionarit, për aq sa

këto të Dhëna të Autoritetit bëhen të papërdorshme, Autoriteti mund t'i kërkojë Koncesionarit (me shpenzimet e Koncesionarit) të rikuperojë ose rikthejë të Dhënat e prekura të Autoritetit sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se peë (5) Ditë Pune nga njoftimi i Autoritetit.

- 35.6 Nëse në cdo kohë Koncesionari dyshon ose ka arsye të besojë se të Dhënat e Autoritetit janë korruptuar, kanë humbur ose janë pakësuar në cfarëdo mënyrë dhe për cfarëdo arsye, atëherë Koncesionari do të njoftojë menjëherë Autoritetin për veprimin e riparimit që Koncesionari propozon të ndërmarrë.

36. Mbrojtja e të Dhënave

Koncesionari pranon të përmbushë të gjitha kërkesat për të Dhënat për Mbrojtjen e Legjislacionit në dispozitat e tij të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate.

37. Detyrime të Vecanta të Autoritetit

- 37.1 Kur Koncesionari i dërgon Autoritetit dokumente për aprovim, të tilla si, Dizenjime, plane ose kërkesa, Autoriteti do të rishikojë këto dokumente dhe ose do të dërgojë miratimin e tij ose arsyet për mos-aprovim brenda dhjetë (10) Ditëve Punë nga marrja e këtyre dokumenteve nga Autoriteti, përvec rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kontratë ose për shkak të volumit të madh të dokumenteve të dërguara.
- 37.2 Autoriteti do të dërgojë të gjitha Certifikatat për Arritjen e Objektivave brenda pesëmbëdhjetë ditëve (15) Ditëve Punë pas përfundimit të suksesshëm të Testeve.

38. Detyrimet e Përgjithshme të Autoritetit

- 38.1 Autoriteti do të sigurojë që Koncesionari të pajiset me të dhënat dhe informacionin që lidhet me përmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate dhe/ose që kërkohet për qëllimin e menaxhimit, funksionimit dhe zhvillimit të kësaj Kontrate dhe do të informojë Koncesionarin për cdo ndryshim ose shtesë të këtyre të dhënave ose informacioni dhe do t'i japë kopje Koncesionarit të këtyre të dhënave ose informacion sipas kërkesës së arsyeshme.
- 38.2 Autoriteti do të përmbushë cdo detyrim të mëtejshëm që përmendet në Aneksin 8.
- 38.3 Autoriteti do të bëjë përpjekjet maksimale për të siguruar që Prodhuesit e Rangut të Lartë të përmbushin sa më shpejt të jetë e mundur pas Datës Efektive dhe sic parashikohet në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse të lejuara, kërkesat e

mëposhtme të prodhuesit sipas miratimit të arsyeshëm të Koncesionarit (“**Gatishmëria e Fabrikës**”):

- (a) aksesin për Personelin e Koncesionarit ndaj linjave të prodhimit të Prodhuesit të Rangut të Lartë për një vlerësim të instalimeve të Pajisjeve Koncesionare;
- (b) disponueshmërinë e lidhjes me internet, instalimit të një rrjeti të përshtatshëm të dedikuar dhe të energjisë elektrike në afërsi të Pajisjes Koncesionare Brenda fabrikës;
- (c) disponueshmërinë e dhomës me kyç;
- (d) disponueshmërisë e ajrit të kompresuar në afërsi të Pajisjes Koncesionare që duhet të instalohet në linjat e prodhimit sipas udhëzimeve të zbatimit të dhëna nga Koncesionari;
- (e) disponueshmërinë e hapësirave të linjës për instalimin e Pajisjes Koncesionare;
- (f) disponueshmërinë e aplikatorëve të klasifikimit në linjën e prodhimit.

39. Vijimësia e Biznesit

- 39.1 Plani për Vijueshmërinë e Biznesit, i bazuar në parimet e paraqitura në Nenin 39 dhe në Aneksin 23, do t’i jepet Autoritetit nga Koncesionari brenda tre (3) muajve pas Datës Efektive. Palët Kryesore do të përmbushin dispozitat e Planit për Vijueshmërinë e Biznesit. Koncesionari do të sigurojë që ai është i aftë të zbatojë Planin për Vijueshmërinë e Biznesit në cdo kohë dhe në përputhje me termat e tij.
- 39.2 Koncesionari do të testojë rregullisht Planin për Vijueshmërinë e Biznesit dhe në cdo rast jo më pak se një herë në cdo periudhë dymbëdhjetë (12) mujore. Sipas Nenit 39.3 Autoriteti mund t’i kërkojë Koncesionarit të kryejë teste shtesë të Planit për Vijueshmërinë e Biznesit aty ku Autoriteti e cmon të nevojshme, duke përfshirë rastet ku ka patur ndonjë ndryshim në Shërbime ose ndonjë proces biznesi ose gjatë shkaktimeve të ndonjë rasti që mund të rrisë gjasat e nevojës për të zbatuar Planin për Vijueshmërinë e Biznesit.
- 39.3 Nëse Autoriteti kërkon një testim shtesë të Planit për Vijueshmërinë e Biznesit ai do t’i dërgojë Koncesionarit një njoftim me shkrim dhe Koncesionari do të drejtojë testimin sipas kërkesave të Autoritetit dhe dispozitave përkatëse të Planit për Vijueshmërinë e Biznesit. Kostot e Koncesionarit për testimet shtesë do të paguhet nga Autoriteti përveç kur Plani për Vijueshmërinë e Biznesit dështon në kryerjen e testimit shtesë,

rast në të cilin kostot e Koncesionarit për këtë testim të dështuar do të paguhen nga Koncesionari.

- 39.4 Koncesionari do të ndërmarrë vlerësimet e duhura të riskut në lidhje me ofrimin e Shërbimeve jo më pak se një herë në cdo gjashtë (6) muaj dhe do t'i japë këto rezultate të, dhe cdo rekomandim në lidhje me këto vlerësime risku Autoritetit menjëherë me shkrim pas cdo analize.

40. Rastet e Forcës Madhore

40.1 Me shkaktimin e një Rasti të Forcës Madhore, do të gjejnë zbatim si më poshtë:

40.1.1 Kjo Kontratë nuk zgjidhet përveç kur parashikohet ndryshe në Nenin 49;

40.1.2 Nëse ndodh një Rast i Forcës Madhore para Datës Efektive, afati për arritjen e Datës Efektive do të shtyhet nga periudha gjatë së cilës vazhdon Forca Madhore; dhe

40.1.3 Nëse ndodh një Rast i Forcës Madhore pas Datës Efektive, Afati do të shtyhet nga periudha gjatë së cilës vazhdon Rasti i Forcës Madhore.

41. Dëmshpërblimi

41.1 Sipas Nenit 43, Koncesionari në cdo kohë gjatë dhe pas Afatit, në lidhje me cdo pretendim të përshkruar në pikat 41.1.1 ose 41.1.2 më poshtë (cdo "Pretendim i Koncesionarit") që lidhet me ndonjë rast ose rrethanë që ndodh ose ekziston gjatë Afatit, dëmshpërblen Autoritetin dhe e mban Autoritetin të zhdëmtuar kundrejt të gjitha humbjeve, dëmtimeve, kostove ose shpenzimeve dhe detyrimeve të tjera (duke përfshirë të gjitha tarifatat ligjore) të shkaktuara nga, që jepen kundrejt ose që pranohen për tu paguar nga Autoriteti që burojnë nga:

41.1.1 një Pretendim IPR;

41.1.2 Një pretendim i ngritur nga një Prodhues kundrejt Autoritetit për dëmet që rezultojnë nga veprimet e Koncesionarit.

41.2 Autoriteti në cdo kohë, gjatë dhe pas Afatit, në lidhje me ndonjë pretendim që përshkruhet në Pikën (një "Pretendim i Autoritetit" dhe bashkë me Pretendimin e Koncesionarit "**Pretendimi**") që lidhet me ndonjë rast ose rrethanë që ndodh ose ekziston gjatë Afatit, dëmshpërblen Koncesionarin dhe e mban Koncesionarin të zhdëmtuar kundrejt të gjitha humbjeve, dëmtimeve, kostove dhe shpenzimeve dhe detyrimeve të tjera (duke përfshirë të gjitha tarifatat ligjore) të shkaktuara nga, të dhëna kundrejt ose të pranuar në mënyrë të arsyeshme për tu paguar nga Koncesionari që

burojnë nga ndonjë pretendim i kërkuar nga një Prodhues ose Importues kundrejt Koncesionarit për dëmtimet që rezultojnë nga ose në lidhje me veprimet e Autoritetit.

41.3 Cdo Autoritet dhe Koncesionari pranojnë se:

41.3.1 nëse kjo Palë Kryesore (“**Pala e Dëmshpërblyer**”) merr dijëni për ndonjë Pretendim për të cilin Pala e Dëmshpërblyer mund të kërkojë ndonjë të drejtë për dëmshpërblyer sipas Nenit 41.1 ose 41.2, sipas rastit, Pala e Dëmshpërblyer do të njoftojë Palën Kryesore detyrimisht në lidhje me këtë të drejtë Dëmshpërblyerimi (“**Pala Dëmshpërblyese**”) të këtij Pretendimi me shkrim, përshkruan këtë pretendim në detaje të pranueshme;

41.3.2 nëse Pala e Dëmshpërblyer do të lejojë Palën Dëmshpërblyese të drejtojë të gjitha bisedimet dhe seancat në lidhje me Pretendimin përkatës, dhe do të pajisë Palën Dëmshpërblyese me asistencën e nevojshme të kërkuar nga Pala Dëmshpërblyese, me shpenzimet e Palës Dëmshpërblyese; dhe

41.3.3 Pala e Dëmshpërblyer nuk do të, pa u këshilluar fillimisht me Palën Dëmshpërblyese bëjë ndonjë pranim në lidhje me Pretendimin në fjalë.

41.4 Pala Dëmshpërblyese do të rishikojë dhe mbrojë cdo Pretendim me kujdes duke përdorur këshillim kompetent dhe në mënyrë që të mos dëmtojë rreputacionin e Palës së Dëmshpërblyer.

41.5 Pala Dëmshpërblyese nuk do të zgjidhë ose bëjë kompromisë me ndonjë Pretendim pa miratimin paraprak me shkrim të Palës së Dëmshpërblyer (miratim i cili nuk duhet të mbahet ose vonohet pa shkak).

41.6 Sa i përket cdo Pretendimi të IPR, Koncesionari mundet që, me shpenzimet e veta dhe sipas zgjedhjes së tij, ose të:

41.6.1 sigurojë për Autoritetin të drejtën për të vazhduar të përdorë artikullin përkatës që është objekt i Pretendimit IPR; ose

41.6.2 të zëvendësojë ose modifikojë artikullin përkatës me alternativa jo-shkelëse, me kusht që:

(a) performanca dhe funksionimi i artikullit të zëvendësuar ose të modifikuar është të paktën ekuivalent me performancën dhe funksionalitetin e artikullit fillestar; ose

(b) (i) artikulli i zëvendësuar ose i modifikuar nuk ka efekt të pafavorshëm në ndonjë Shërbim ose Sistem, Sistemin Qëndror të Monitorimit dhe Gjurmimit

ose ndonjë Njësi Kompjuterike; (ii) nuk ka kosto shtesë ëpr Autoritetin; dhe (iii) kushtet e Kontratës do të gjejnë zbatim në artikullin e zëvendësuar ose të modifikuar.

41.7 Nëse Koncesionari zgjedh të modifikojë ose të zëvendësojë një artikull sipas Nenit 41.6.2 ose të sigurojë një licensë sipas Nenit 41.6.1, por ky veprim nuk shmang ose zgjidh Pretendimin IPR, atëherë Autoriteti mund të zgjidhë këtë Kontratë me njoftim me shkrim me efekt të menjëhershëm dhe Koncesionari do të, sipas Nenit 43, mbajë përgjegjësi për të gjitha kostot e arsyeshme dhe të pashmangshme të artikujve zëvendësues dhe/ose shërbimeve, duke përfshirë cdo kosto shtesë mbi dhe përtej kostove të shkaktuara nga Autoriteti këtu, për sigurimin dhe mirembajtjen e këtyre artikujve zëvendësues.

41.8 Dispozitat e Nenit 41 nuk do të gjejnë zbatim në lidhje me Pretendimin IPR të shkaktuar nga:

41.8.1 ndonjë përdorim i Softëare të Autoritetit nga Koncesionari sipas udhëzimeve me shkrim që jepen nga Autoriteti; ose

41.8.2 ndonjë përdorim të Softëare të Specifikuar me Shkrim, të Softëare të Koncesionarit ose Softëare të Palës së Tretë nga Autoriteti në një mënyrë që nuk tregohet tek Kërkesat, Zgjidhja ose dispozitat e kësaj Kontrate.

42. Konfidencialiteti

42.1 Përvec sa parashikohet në këtë Nen ose lejohet më tej shprehimisht në këtë Kontratë, secila Palë do të:

42.1.1 trajtojë Informacionin Konfidencial të Palës tjetër si konfidencial dhe do ta mbrojë në përputhje me rrethanat; dhe

42.1.2 nuk do t'i zbulojë Inforamcionin Konfidencial të Palës tjetër, ndonjë personi tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.

42.2 Neni 42.1 nuk gjen zbatim për aq sa ky informacion të jetë:

42.2.1 në zotërim të Palës që bën zbulimin pa zbatuar detyrimin e konfidencialitetit para zbulimit nga ajo Palë;

42.2.2 siguruar nga një palë e tretë pa ndonjë detyrim konfidencialiteti;

- 42.2.3 tanimë në zotërim publik në kohën e zbulimit, e ndryshme nga ndonjë Shkelje e kësaj Kontrate;
- 42.2.4 zhvilluar në mënyrë të pavarur pa patur akses ne Informacionin Konfidencial të Palës tjetër; ose
- 42.2.5 në kohën e zbulimit të kërkohet me Ligj për tu zbuluar.
- 42.3 Koncesionari mund të zbulojë Informacionin Konfidencial të Autoritetit vetëm për, Personelin e Koncesionarit që përfshihet direkt në ofrimin e Shërbimeve dhe të cilët duhet të dinë informacionin, dhe duhet të sigurojë që ky Personel i Koncesionarit të jetë i informuar për dhe të përmbushë detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj Kontrate në lidhje me trajtimin e Informacionit Konfidencial.
- 42.4 Koncesionari nuk do të, dhe do të sigurohet që Personeli i Koncesionarit të mos, përdorë Informacionin Konfidencial të Autoritetit përveçse për qëllimet e kësaj Kontrate.
- 42.5 Koncesionari merr përsipër (përveç kur kërkohet me Ligj ose me një urdhër për të udhëzuar konsulentët profesionistë në lidhje me këtë Kontratë) të mos:
- 42.5.1 zbulojë ose të lejojë zbulimin e ndonjë detaji të kësaj Kontrate për median ose ndonjë palë të tretë nga Nënkontraktuesit;
- 42.5.2 përdorë emrin e Autoritetit dhe/ose markën tregtare ose firmën në ndonjë promocion ose marketim ose shpallje të rregullave pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit.
- 42.6 me kërkesën me shkrim të Autoritetit, Koncesionari do të sigurojë që ata anëtarë të Personelit të Koncesionarit të identifikuar në një njoftim me shkrim nga Autoriteti, të firmosin një kontratë konfidencialiteti, duke përfshirë para fillimit ndonjë punë në lidhje me këtë Kontratë.
- 42.7 Asgjë në këtë Kontratë nuk do të pengojë Autoritetin t'i zbulojë Informacionin Konfidencial Koncesionarit:
- 42.7.1 për cdo Institucion Shtetëror. Të gjitha Institucionet Shtetërore që sigurojnë Informacionin Konfidencial do të kenë të drejtë ta zbulojnë më tej këtë Informacion Konfidencial tek Institucione të tjera Shtetërore, në bazë të asaj që, informacioni është konfidencial dhe nuk duhet t'i zbulohet ndonjë palë të tretë e cila nuk është Institucioni Shtetëror ose Autoriteti;

- 42.7.2 vetëm nëse ekziston një “nevojë-për-të-ditur”, nga ndonjë konsulent, auditues, ose person tjetër i angazhuar nga Autoriteti nëse ky person pranon të mbajë informacionin konfidencial.
- 42.8 Autoriteti do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të mundësuar që cdo department i qeverisë, punonjës, palë e tretë ose Nënkontraktues të cilit i zbulohet Informacioni Konfidencial i Koncesionarit sipas Nenit 42.7, të ketë dijeni për detyrimin e konfidencialitetit të Autoritetit.
- 42.9 Asgjë në Nenin 42 nuk do të pengojë ndonjë Palë të përdorë teknika, ide, ose Njohuri Teknike të fituara gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, gjatë vërtetimit të saj të zakonshme të biznesit, ose aktiviteteve për aq sa ky përdorim nuk rezulton në zbulimin e Informacionit Konfidencial të ndonjë Palë tjetër ose në një shkelje të të Drejtave mbi Pronësinë Intelektuale. Për të shmangur dyshimin, detyrimet e Koncesionarit sipas Nenit 42 nuk do të pengojnë Koncesionarin për (a) t’iu referuar Sistemit dhe Shërbimeve në materialet e tij të marketimit dhe të sigurojë informacion mbi Sistemin dhe Shërbimet për klientët e tij të mundshëm; dhe (b) të përdorë informacionin e fituar gjatë përpunimit dhe funksionimit të Sistemit dhe Shërbimeve në brendësi, për të ndihmuar në zhvillimin e projekteve të tjera; me kusht që, në cdo rast, ky zbulim ose përdorim të mos nxjerrë Informacionin Konfidencial të Autoritetit tek palët e treta të papërfshira.

43. Përgjegjësia

- 43.1 Koncesionari deklaron se Sistemi dhe Pullat Fiskale që ai prodhon sipas kësaj Kontrate do të jenë pa të meta gjatë Afatit. Nëse do të ndodh ndonjë defekt në lidhje me Sistemin ose Pullat Fiskale, pa çënuar të drejtat dhe mjetet e tjera të Autoritetit:
- 43.1.1 sa i përket ndonjë Defekti në lidhje me (a) Sistemin, Koncesionari do të rregullojë këtë Defekt duke riparuar ose zëvendësuar komponentin e prekur, ose (b) sa i përket ndonjë Defekti në ndonjë Pullë Fiskale, Koncesionari do të rregullojë këtë Defekt duke zëvendësuar këtë Pullë Fiskale, në cdo rast brenda periudhave të parashikuara në Aneksin 5; dhe
- 43.1.2 koncesionari do të paguajë kostot e, dhe të shkaktuara nga, rregullimi i ndonjë Defekti sipas Nenit 43.1.1, duke përfshirë stafin e ofruar për të zbatuar ndonjë riparim të nevojshëm ose instalimin e komponentëve të zëvendësuar.
- 43.2 Asgjë në këtë Kontratë nuk do të kufizojë përgjegjësinë e secilës Palë Kryesore për:
- 43.2.1 vdekjen ose plagosjen personale të shkaktuar nga neglizhenca e saj ose neglizhenca e punonjësve të saj, agjentëve ose Nënkontraktuesve (aty ku zbatohet); ose

- 43.2.2 mashtrimi i saj ose i punonjësve të saj.
- 43.3 Shuma totale e përgjegjësisë së Koncesionarit si më poshtë:
- 43.3.1 sa i përket Kredive të Shërbimit do të kufizohen në total në një shumë maksimale të 200,000 EURO (dyqind mijë) për cdo Vit Kontraktual; dhe
- 43.3.2 në lidhje me të gjitha pretendimet e tjera, humbjet ose dëmtimet, qoftë kontraktore ose jo-kontraktore që burojnë nga ose në lidhje me një Shkelje të kësaj Kontrate ose në ndonjë mënyrë tjetër të lidhura me këtë Kontratë, në asnjë rast nuk do të terjkalojnë shumën e 10,000,000 Euro (dhjetë million)
- 43.4 Sipas Neneve 43.3 dhe 43.6, asnjë Palë Kryesore nuk mban përgjegjësi ndaj Palës tjetër Kryesore për:
- 43.4.1 ndonjë humbje indirekte të rëndësishme ose dëmtim; ose
- 43.4.2 ndonjë humbje indirekte ose fitim, xhiro, mundësi biznesi ose dëmtim në mirëbesim.
- 43.5 Sipas kufizimeve të përgjegjësisë në Nenet 43.3 dhe 43.4, Autoriteti mund të rikuperojë si humbje direkte:
- 43.5.1 cdo kosto dhe shpenzim shtesë operacional dhe/ose administrativ që burojnë nga Shkelja e Koncesionarit;
- 43.5.2 cdo shpenzim ose komision i paguar nga Autoriteti si rezultat i Shkeljes së Koncesionarit ose i cili u pagua nga Autoriteti por është ofruar në mënyrë të panevojshme si rezultat i Shkeljes së Koncesionarit;
- 43.5.3 cdo shpenzim që del nga prishja ose humbja e të Dhënave të Autoritetit; dhe;
- 43.5.4 kostot shtesë të sigurimit të Shërbimeve të Zëvendësimit për tepricën e Afatit.
- 43.6 Palët Kryesore pranojnë se nëse ndonjë kufizim ose dispozitë e referuar shprehimisht në Nenin 43 do të quhet si e pavlefshme sipas Ligjit, ai do të konsiderohet e lënë jashtë, dhe nëse Pala Kryesore mban përgjegjësi për humbjen ose dëmtimin për të cilën ky kufizim ose dispozitë u zbatua, ajo përgjegjësi do t'i nënshtrohet kufizimeve të mbetura dhe dispozitave të paraqitura në Nenin 43.
- 43.7 Asgjë në Nenin 43 nuk redukton ose ndikon në detyrimin e përgjithshëm të Palës Kryesore për të lehtësuar humbjen.

43.8 Sipas Neneve 43.4, 43.5 dhe 43.6, shuma totale e përgjegjësisë të Autoritetit ndaj Koncesionarit (përveç detyrimit të Autoritetit për të paguar Komisionet në afat), për cdo Shkelje nga Autoriteti sipas Kontratës, në cdo rast nuk do t'i kalojë Euro 10,000,000.

44. Siguracionet

44.1 Subjekt i zbatimit të Nenit 44.2, Koncesionari do të do të marri dhe mbajë ose të sigurojë mbajtjen e sigurimeve në përputhje me Aneksin 7.

44.2 Nëse në cd kohë Koncesionari nuk ka mundësi të mbajë ndonjë sigurim të kërkuar në përputhje me Aneksin 7, Koncesionari do të pajis menjëherë Autoritetin me mbulim të barzvllefshëm npërmjet një letër kredie.

45. Detyrime të caktuara të Koncesionarit

45.1 Koncesionari do të:

45.1.1 Shpërndajë në cdo kohë burime të mjaftueshme për të siguruar Shërbimet në përputhje me afatet e kësaj Kontrate;

45.1.2 marri dhe mbajë gjatë Afatit të gjithë miratimet, licensat dhe autorizimet (ligjore, rregullatore, kontraktuale apo cdo lloj) e nevojshme dhe të cilat janë të nevojshme për të mundësuar kryerjen e Shërbimeve; dhe

45.1.3 sigurojë gjatë Afatit furnizuesve të tjerë të Autoritetit të cilët i njoftohen periodikisht Koncesionarit, bashkëpunim të arsyeshëm informacion (duke përfshirë cdo Dokumentacion), këshillë dhe asistencë në lidhje me Shërbimet, Sistemin e Monitorimit të Gjurmimit dhe Gjetjes dhe/ose Njësitë e Kompjuterave për të bërë të mundur secilit prej këtyre personave për të krijuar dhe mbajtur ndërfaqe orgainzative ose teknike me Shërbimin dhe këto sisteme dhe njësi me zgjidhjen apo përfundimin e Kontratës të mundësojë kalimin në kohë të secilit prej Shërbimeve ose sistemeve dhe njësive tek cdo Koncesionar Zëvendësues.

46. Deklarimet dhe Garancitë

46.1 Autoriteti deklaron dhe garanton se, që nga data e kësaj Kontrate gjatë Afatit:

46.1.1 Ai ka kompetenca të plota dhe autoritetin për të nënshkruar, dorëzuar dhe përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe të përmushë transaksionet e parashikuara në të;

- 46.1.2 Kjo Kontratë përbën detyrimet e tij të ligjshme të vlefshme dhe detyrese, të zbatueshme në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj kontrate;
- 46.1.3 pronat/asetet për zbatimin dhe përmbushjen e kësaj Kontrate të zotëruara nga Autoriteti janë dhe do të qëndrojnë të lira nga të drejtat e palëve të treta gjatë Afatit;
- 46.1.4 ai ka marrë të gjithë autorizimet dhe lejet e nevojshme për të qënë palë e kësaj kontrate;
- 46.1.5 nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nuk do të jetë në konflikt me, rezultojë në mospërmbushje të, përbëjë mospërmbushje sipas apo të përshpejtojë përmbushjen e kërkuara nga secili prej kushteve të cdo Ligji ose angazhimi, kontrate, marrëveshje, dekreti apo urdhri në të cilin ai është palë ose ndërmjet të cilit ai apo ndonjë prej pronave ose aseteve të tij janë të kufizuara apo të prekura.
- 46.2 Koncesionari deklaron dhe garanton autoritetin se që nga Data Efektive dhe gjatë Afatit;
- 46.2.1 Ai është organizuar dhe ekziston vlefshërisht si një shoqëri sipas ligjeve të vendit të tij të origjinës;
- 46.2.2 kjo Kontratë përbën detyrimet e tij të ligjshme të vlefshme dhe detyrese, të zbatueshme kundrejt tij në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj kontrate;
- 46.2.3 ai ka kompetencë dhe autoritet të plotë të nënshkruajë, dorëzojë, dhe të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe të kryejë transaksionet e parashikuara në këtë kontratë;
- 46.2.4 ai ka marrë të gjithë autorizimet e nevojshme të shoqërisë dhe veprimet e tjera të kërkuar sipas Ligjit dhe dokumentave të tij të themelimit me qëllim për të lejuar nënshkrimin dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Kontrate;
- 46.2.5 ai ka qëndrueshmëri dhe kapacitet financiar për të marrë përsipër detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate;
- 46.2.6 ai do të përmbushë detyrimet e tij me kujdesin e kërkuar profesional në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë;
- 46.2.7 ai nuk është në paafësi pagueuese dhe është në përputhje të plotë me Ligjet dhe dispozitat e kësaj Kontrate;
- 46.2.8 deklaratimet dhe garancitë në Zgjidhje dhe kudoqofshin në këtë Kontratë apo në ndonjë dokument tjetër të paraqitur prej tij tek Autoriteti apo tek cdo Institucion Shtetëror në

- kidhje me Koncesionin janë, për aq sa ai ka dijeni, informacion dhe besim, të vërteta dhe të sakta dhe ai do të njoftojë Autoritetin për çdo fakt, çështje apo rrethanë për të cilën ai mund të marrë dijeni e cila do të bëntë që çdo deklaram apo garanci të ishin jo të vërteta apo konfuze;
- 46.2.9 asnjë Ngjarje Falimentimi nuk ka në lidhje me Koncesionarin dhe Koncesionari ka mundësitë dhe kapacitetin financiar për të marrë përsipër detyrime sipas kësaj Kontrate;
- 46.2.10 ai do të sigurojë që të gjithë elementë e Sistemit të nevojshëm për kryerjen e Shërbimeve të jenë mbajtur dhe azhurnohen në përptuhje me Nenin 15;
- 46.3 koncesionari garanton, deklaron dhe merr përsipër gjatë Afatit se:
- 46.3.1 çdo Pullë Fiskale që ai prodhon do të:
- (a) shënohet në atë mënyrë që Përdoruesi që përdor Njësinë e Kompjuterit tëketë mundësi të marrë menjëherë nga Sistemi Qendror per Monitorimin e Gjurmeve të dhënat në lidhje me Pullën Fiskale që është përcaktuar në Kërkesat, Zgjidhjet dhe kudo tjetër në këtë Kontratë për një periudhë prej (2) vjetësh nga Prodhimi i asaj Pulle Fiskale; duke patur parasysh që (i) ajo Pullë Fiskale është ruajtur sipas kushteve normale sipas procedurave të akonshme për të mbrojtur atë Pullë Fiskale nga ekspozimi i tepruar kundrejt dritës dhe kushteve ambientale dhe (ii) një rrjet të dhënash është i arritshëm në të cilin ata Njësi Kompjuterash mund të komunikojnë me Sistemin Qendror per Monitorimin e Gjurmeve; dhe
 - (b) përmbajë të gjithë karakteristikat e zbatueshme të sigurisë të përcaktuara te Kërkesat, Zgjidhja dhe kudo tjetër në këtë Kontratë;
- 46.3.2 stafi i përdorur për të kryer Shërbimet do të punësohet në përptuhje me Praktikën e Industrisë së Mirë dhe kërkesat e tjera sipas kësaj Kontrate;
- 46.3.3 ai ka dhe do të vazhdojë të mbajë (nëse ka) të gjithë miratimet, lejet, licensat pëlqimet dhe autorizimet rregullatore nga Institucionet Shtetërore të cilat janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet e Koncesionarit sipas Kësaj Kontrate;
- 46.3.4 ai ka dhe do të vazhdojë të ketë të gjithë të drejta në dhe tek Software- i Koncesionarit, Software-i i Palëve të Treta dhe/ose te the Concessionaire's Background IPR, the Central Track and Trace Monitoring System, the njësitë e kompjuterave, apo çdo material tjetër i vënë në dispozicion nga Koncesionari dhe/ose Nënkontraktori për Autoritetin, i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të koncesionarit sipas kësaj Kontrate;

- 46.3.5 gjatë përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, të gjithë Software-et e Koncesionarit, Software-et e Palëve të Treta dhe Software-i i Shkruajtur Posacërisht i përdorur nga ose në emër të Koncesionarit do të:
- (a) jenë versione aktuale të përballueshme të programit; dhe
 - (b) funksionojnë në të gjithë aspektet materiale në përputhje me Kërkesat, Zgjidhjen dhe kushtet e tjera të kësaj Kontrate;
- 46.3.6 back-up do të përmbajë të gjithë informacionin dhe shpjegimet e nevojshme të këkuara për të mundësuar nëpunësit mjaftueshmërisht të kualifikuar të Autoritetit apo Koncesionarit Zëvendësues të mundësi të përdorin Sistemin, marrin Shërbimet dhe të kryejnë Shërbimet e Zëvendësimit në zgjidhjen apo përfundimin e kësaj Kontrate;
- 46.3.7 pa pëlqimin e Autoritetit, ai nuk do të, barrësojë Sistemin apo asetet e përdorura gjatë kryerjes së Shërbimeve. Për qëllime të këtij Neni “barrësim” do të përfshijë dhënien e ndonjë intersi apo kapitali tek cdo person (duke përfshirë cdo të drejtë për të blerë, të drejta me kusht apo të drejtë parablerje) apo cdo hipoteke, barrë, peng, kalim, interes të siguarur dhe cdo kontratë apo marrëveshje sigurimi e cila do të kufizonte qoftë aftësinë e Palës Kryesorë për të përdorur dhe tregtuar pjesën e rëndësishme të Sistemit apo asetet;
- 46.3.8 të gjithë detyrimet dhe përgjegjësitë e Koncesionarit sipas kësaj Kontrate do të përmbushen nga personel me eksperiencën e duhur, të kualifikuar dhe trajnuar me të gjitha aftësitë, kujdesin dhe përkushtimin; dhe
- 46.3.9 ai do të veprojë dhe mbajë pajisjet e përdorura në lidhje me këtë Kontratë në gjëndje të mirë pune dhe nëse nevojitet ai do të modifikojë, riparojë ose do të bëjë përmirësimet në këto ambiente për të arritur të gjithë kërkesat e parashikura në këtë Kontratë dhe në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë dhe Ligjet.

47. Siguria

- 47.1 Koncesionari do të marrë masa që të gjitha Pullat Fiskale që ai prodhon të përputhen me specifikimet e sigurisë të përcaktuara në Kërkesat, Zgjidhjen dhe kudo tjetër në këtë Kontratë.
- 47.2 Koncesionari do të pajtohet dhe do të sigurojë përputhshmërinë e Stafit të Koncesionarit, me dispozitat e sigurisë të përcaktuara në këtë Kontratë.
- 47.3 Autoriteti do një noftojë Koncesionarin për cdo ndryshim të propozuar në Politikën e Sigurisë.

- 47.4 Nëse Koncesionari beson se një ndryshim ose ndryshim i propozuar i Politikave të Sigurisë do të ketë një ndikim të pashmangshëm dhe material në koston e Shërbimeve ai mund të paraqesi një Kërkesë Ndryshimi. Duke bërë kështu, Koncesionari duhet të mbështesi kërkesën e tij duke paraqitur prova të shkakut të cdo kosto të rritur dhe hapat që ai ka ndërmarrë për të zvogëluar ato kosto. Cdo ndryshim i Komisioneve do të vendoset më tej në përputhje me Procedurat e Ndryshimit të Kontrollit.
- 47.5 Deri në dhe/ose nëse një ndryshim të i Charges është rënë dakort nga Autoriteti sipas Nenit 47.4 Koncesionari do të vazhdojë të kryejë Shërbimet në përputhje me detyrimet e tij ekzistuese.
- 47.6 Koncesionari do të veprojë në përputhje me Procedurat e Verifikimit të Stafit sic i paraqiten kohë pas kohe Autoritetit nga Koncesionari në lidhje me Stafin e Koncesionarit të punësuar apo angazhuar në kryerjen e Shërbimeve. Koncesionari konfirmon se i gjithë Stafit i Koncesionarit i punësuar apo angazhuar nga Koncesionari në Datën Efektive janë rishikuar dhe rekrutuar mbi baza që janë të barabarta me dhe jo më pak strikte se Procedurat e Verifikimit të Stafit të paraqitura Autoritetit nga Koncesionari përpara Datës Efektive.
- 47.7 Koncesionari do të sigurojë trajnime mbi baza të vazhdueshme për të gjithë Stafin e Koncesionarit të cilat janë punësuar apo angazhuar në kryerjen e Shërbimeve në përputhje me Politikën e Sigurisë.
- 47.8 Koncesionari do të, si një detyrim i vazhdueshëm gjatë Afatit, përdorë versionet më të fundit të programeve anti-virus të mundësuar nga një industri e pranuar për shitjen e programeve anti-virus për të kontrolluar dhe fshirë Software-et Malicious nga Sistemi.
- 47.9 Pavarësisht Nenit 47.8, nëse Software-i Malicious gjendet, Palët Kryesore do të bashkëpunojnë për të reduktuar efektet e Software-ve Malicious dhe, vecanërisht nëse Software-i Malicious shkakton një humbje të efikasitetit operacionale ose humbje ose korruptim të të Dhënave të Autoritetit, të asistojnë njëri tjetrit për të zvogëluar humbjet dhe të kthejnë Shërbimet në nivelin normal të operimit të tyre.
- 47.10 Kostot që vijnë nga veprimet e Palëve Kryesore, të cilat janë marrë për sipas dispozitave të Neneve Articles 47.8 dhe 47.9, do të ngarkohen Palëve Kryesore si vijon:
- 47.10.1 Nga Koncesionari kur Software-et Malicious burojnë nga Software-et e Koncesionarit, Software-et e Palëve të Treta, Software-i i Shkruajtur Specifikisht ose Të të Dhënave të Autoritetit (ndërsa të Dhënat e Autoritetit ishte nën kontrollin e Koncesionarit); dhe

47.10.2 Nga Autoritetit nëse Software-et Malicious burojnë nga Software-et e Autoritetit ose Të Dhënat e Autoritetit (ndërsa të Dhënat e Autoritetit ishin nën kontrollin e Autoritetit).

48. Të Drejtat dhe Detyrimet e Koncesionarit

48.1 Përveç të drejtave të tjera që burojnë nga kjo Kontratë, Koncesionari do të ketë të drejtë të:

48.1.1 Ushtrijë të gjithë të dejtat e lidhura me përdorimin e lirë dhe posedimin e Vendndodhjes Qendrore të Prodhimit gjatë Afatit dhe në përputhje me qëllimin dhe dispozitat e kësaj Kontrate, pa bërë asnjë pagesë tek Autoriteti, duke patur parasysh se Koncesionari nuk mund të vendosi barrë, peng apo të lidhë marrëveshje siguroese në lidhje me këto ambiente;

48.1.2 Punësojë, angazhojë punonjës, duke përfshirë Stafin Kyç, me qëllim për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe të draftojë politikën e tij të punësimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe kushtet e kësaj Kontrate;

48.1.3 Të kryejë ato veprime të tjera që ai konsideron të nevojshme për të qënë në përputhje me detyrimet e tij dhe të ushtrijë të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate; dhe

48.1.4 Zgjasi Afatin në përputhje me Nenin 3.3.

48.2 Përveç detyrimeve të tjera të tij që burojnë nga kjo Kontratë, Koncesionari do të ketë detyrimet e mëposhtme:

48.2.1 Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë ose kur Palët Kryesore bien dakort ndryshe me shkrim, Koncesionari do të mbulojë të gjitha kostot dhe shpenzimet të cilat shoqërohen me përmbushjen e detyrimeve të tij në përputhje me këtë kontratë dhe Anekset e saj;

48.2.2 gjatë Afatit, Koncesionari do të përputhet me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi në lidhje me specifikimet teknike të Pulave Fiskale për aq sa ato janë të zbatueshme;

48.2.3 përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë Kontratë apo Ligj, KONcesionari do të aplikojë dhe pagujë për të marrë dhe mbajtur të gjithë autorizimet dhe lejet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate;

- 48.2.4 Koncesionari do të caktojë, mbikqyrë, monitorojë dhe kontrollojë aktivitetet e Nënkontraktorëve (sipas kontratave respektive ashtu sic do të jetë e nevojshme), në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe Anekseve të saj; dhe/ose
- 48.2.5 Pas përfundimit apo mbarimit të Afatit, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate dhe Planin e Daljes, dhe subjekt i përmbushjes në tërësi të detyrimeve të Autoritetit sipas kësaj Kontrate, Koncesionari do të transferojë asetet e përcaktuara në Aneksin 22 tek Autoriteti pa asnjë pagesë të mëtejshme për t'iu kryer Koncesionarit.
- 48.3 Koncesionarit është i detyruar të:
- 48.3.1 Sigurojë që të gjithë Pullat Fiskale që ai prodhon të jenë në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në Kërkesat, Zgjidhja dhe kudo tjetër në këtë Kontratë;
- 48.3.2 Rehabilitojë, përtërij dhe operojë Vendndodhjen Qëndrore të Prodhimit në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate;
- 48.3.3 Projektojë, krijojë, menaxhojë, mbajë, operojë dhe mbikqyrë Sistemin gjatë Afatit në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate;
- 48.3.4 Të siguri që cilësi të lartë, besueshmëri dhe qëndrueshmëri të Sistemit, Sistemit Qendror të Monitorimit të Gjurmëve dhe të Njësive të Kompjuterave gjatë Afatit;
- 48.3.5 Zbatojë një Sistem fleksibël, të përshtatshëm ndaj ndryshimeve legislative dhe ndryshimeve teknologjike të miratuara për Pullat Fiskale, subjekt i zbatimit të Nenit 25 në lidhje me menaxhimin e ndryshimeve të Sistemit;
- 48.3.6 Prodhojë një Sistem, të aftë për përballuar numrin e parashikuar të Pulave Fiskale të kërkuara gjatë Afatit, subjekt i zbatimit të kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë;
- 48.3.7 Subjekt i kufizimeve të përcaktuara në këtë Kontratë, të sigurojë që personat e vetëm të miratuar bashkarisht nga Palët Kryesore të kenë akses në Vendndodhjen Qendrore të Prodhimit dhe vetëm në përputhje me standardet e sigurisë të përcaktuara në Ligj, Politikat e Sigurisë dhe këtë Kontratë;
- 48.3.8 Informojë Autoritetin për çdo rrethanë që mund të prandalojë apo vështirsojë përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate;
- 48.3.9 Raportojojë çdo vit tek Autoriteti në lidhje me progresin e bërë në kryerjen e Shërbimeve, sic përcaktohet në këtë Kontratë; dhe

48.3.10 Të marri të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme për të garantuar sigurinë në kushtet e punës për punëmarrësit e ti dhe të mbikqyrë legjislacionin përkatës për parandalimin e aksidenteve dhe dëmtimeve në vendin e punës.

48.4 Gjatë afatit të gjashtë muajve të njëpasnjëshëm duke filluar nga data që kjo Kontratë përfundon apo zgjidhet, pa kosto për Autoritetin:

48.4.1 Koncesionari me anë të kësaj kontrate jep një të drejtë dhe licensë jo ekskluzive dhe të kufizuar, për territorin e Republikës së Shqipërisë, në lidhje me IPR të Koncesionarit të përfshirë në Sistemin, për të përdorur Sistemin gjatë kësaj periudhe të vazhdueshme gjashtë mujore;

48.4.2 Me kërkesë të Autoritetit, Koncesionari do të negociojë me mirëbesim për të nënshkruar një kontratë të vecantë me anë të së cilës Koncesionari do të japi mbështetje për Sistemin në nivelet e shërbimit që janë më pak të kufizuar sesa Nivelet e Shërbimit;

48.4.3 Autoriteti do të ketë të drejtë të mbajë ndonjë apo të gjithë Njësitë e Kompjuterave gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore të vazhdueshme; dhe

48.4.4 Me kërkesë të Autoritetit, Koncesionari do të negociojë me mirëbesim për të nënshkruar një kontratë të vecantë me anë të së cilës Koncesionari do të sigurojë mirëmbajtje dhe mbështetje për cdo Njësi Kompjuteri të mbajtur nga Autoriteti sipas Nenit 48.4.3 më sipër në një nivel shërbimesh të kufizuar të të ngjashëm me nivelet e shërbimit të ofruara gjatë afatit të kësaj Kontrate.

Me kërkesë të Autoritetit, Koncesionari do të negociojë me mirëbesim për të nënshkruar një kontratë për kryerjen e shërbimeve të përshkruara në Nenin 48.4.1 deri 48.4.4 më sipër pas përfundimit të kësaj periudhe gjashtë mujore të vazhdueshme, në nivele shërbimi të reduktuar të mëtejshme, mbi baza të “kostove shtese”.

48.5 Në lidhje me shërbimet e ofruara nga Koncesionari sipas Nenit 48.4 pas përfundimit apo zgjidhjes së kësaj Kontrate, Koncesionari do të ofrojë ato shërbime me kujdes dhe aftësi të arsyeshme; duke patur parasysh se (i) Koncesionari nuk do të jetë përgjegjës për humbjet, dëmet, kostot apo shpenzimet apo ndonjë përgjegjësi tjetër që rezultojnë nga, rrjedh nga apo në lidhje me ofrimin e këtyre shërbimeve përveç kur këto humbje, dëme, kosto, shpenzime apo përgjegjësi të tjera që vijnë nga keq besimi, neglizhenca e terpuar apo kryerja me dashje nga Koncesionari, dhe (ii) asnjë Kredi Shërbimi nuk do të bëhet i pagueshëm nga Koncesionari pas përfundimit apo zgjidhjes së kësaj Kontrate.

49. Zgjidhja

- 49.1 Përvec të drejtave të tjera për zgjidhje të parcautara në këtë Kontratë, Autoriteti ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë kur:
- 49.1.1 Koncesionari është në Mospërmbushje materiale të ndonjë detyrimi sipas kësaj Kontratë dhe kjo Mospërmbushje është duke vazhduar dhe:
- (a) është e riparueshme; ose
 - (b) është e riparueshme por qëndron e riparuar për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pas marrjes nga Koncesionari të njoftimit në lidhje me Mospërmbushjen;
- 49.1.2 ka një Ndryshim të Kontrollit të Koncesionarit sic përcaktohet në Nenin 27; ose
- 49.1.3 ka një Ngjarje Falimentimi në lidhje me Koncesionarin.
- 49.2 Pavarësisht cdo të drejtë për zgjidhje të përcaktuar diku tjetër në këtë Kontratë, por përvec kur është përcaktuar shprehimisht kundër në këtë Kontratë, Koncesionari, do të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë nëse Autoriteti është në një Mospërmbushje Materiale të detyrimeve të tij materiale sipas kësaj Kontratë dhe kjo Kompërmbushje (i) është e paraiparueshe, ose (ii) është e riparueshme por qëndron e riparuar për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pas marrjes nga Autoriteti të njoftimit në lidhje me Mospërmbushjen.
- 49.3 Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore ose sipas gjykimit të arsyeshëm të Palëve Kryesore, ka gjasa të vazhdojë për një periudhë më të gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj të vazhdueshëm, përvec dispozitave të Nenit 40, cdo Palë Kryesore mund të zgjidhë këtë Kontratë duke dhënë një Njoftim Zgjidhje Palës tjetër Kryesore.
- 49.4 Cdo Palë Kryesore që zgjidh Këtë Kontratë në përputhje me Nenin 49 do ta bëjë një gjë të tillë me anë të një njoftimi me shkrim tridhjetë (30) ditë më parë dërguar Palës tjetër Kryesore (“**Njoftimi i Zgjidhjes**”). Njoftimi i Zgjidhjes do të përmbajë:
- 49.4.1 Detaje të përshtashme për Mospërmbushjen themelore;
 - 49.4.2 Datën e zgjidhjes e cila do të jetë një datë që është jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e Njoftimit të Zgjidhjes;
 - 49.4.3 Kryerjen e pagesës, duke përfshirë detajet e përlllogaritjes; dhe

49.4.4 Cdo informacion tjetër të rëndësishëm.

50. Pasojat e Zgjidhjes

50.1 Në vijim të Njoftimit për Zgjidhje, për çfarëdo arsye, Konçesionari do të vazhdojë të jetë nën detyrimin për të ofruar Shërbimet në Nivelet e kërkuara të Shërbimeve dhe të mundësojë që nuk ka asnjë degradim në Nivelet e Shërbimeve ose standardet e tjera të Shërbimeve, deri në datën e zgjidhjes.

50.2 Në rast të zgjidhjes ose të mbarimit të afatit, Konçesionari do të:

50.2.1 ndërpresë përdorimin e të Dhënave të Autoritetit; dhe

50.2.2 përmbushë detyrimet e tij që përmbahen në ndonjë Plan të miratuar të Daljes.

50.3 Mbarimi i afatit ose zgjidhja e kësaj Kontrate (e shkaktuar në çfarëdo mënyrë) nuk do të prekë ndonjë të drejtë ose detyrim shtesë të asnjërës prej Palëve Kryesore, dhe as do të dëmtojë hyrjen në fuqi ose vazhdimësinë e ndonjë dispozite të kësaj Kontrate, që shprehimisht ose me nënkuptim synon të jetë në fuqi ose të vazhdojë të jetë në fuqi pas mbarimit të këtij afati, ose duke përfshirë zgjidhje, pa u kufizuar me dispozitat e Neneve 31,36,43,50,59,61,62,64, dhe 66 të cilat do t'i mbijetojnë zgjidhjes ose mbarimit të afatit të kësaj Kontrate dhe dispozitat e Nenit 23, të cilat do t'i mbijetojnë zgjidhjes ose mbarimit të afatit të kësaj Kontrate për një periudhë një vjeçare.

51. Menaxhimi i Daljes

51.1 Autoriteti dhe Konçesionari do të pajtohen me kërkesat e menaxhimit të daljes të paraqitura në Aneksin 22 të kësaj kontrate dhe të cdo Plani të Daljes të miratuar më pas. Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kësaj Kontrate, Autoriteti do të ketë këto të drejta:

51.1.1 nëse ndodh një Rast i Paaftësisë Paguese në lidhje me Konçesionarin;

51.1.2 në rastin e zgjidhjes së kësaj Kontrate për cdo arsye; dhe

51.1.3 me mbarimin e Afatit.

52. Ndryshimet

Sipas Proçedurës për Kontrollin e Ndryshimit, ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate mund të ndryshohet, modifikohet, plotësohet ose hiqet, por vetëm me anë të një amendamenti ose suplementi me shkrim, ose dokumenti të heqjes dorë me shkrim, të

firnosur nga Palët Kryesore, por me kusht që cdo amendament, modifikim, plotësim ose heqja dorë në lidhje me (i) Afatin dhe (ii) përcaktimin e çmimit sipas Nenit 17 këtu, do të kërkojë miratimin paraprak të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë. Autoriteti në çdo kohë do të ketë kompetenca të plota dhe autoritet për të nisur cdo amendament të tillë dhe asnjë veprim i, ose autorizim nga, Këshilli Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose ndonjë institucion tjetër qeveritar, do të kërkohe në lidhje me ndonjë amendament të tillë (përveç çështjeve të përmendura në (i) dhe (ii) të fjalisë së mëparshme).

53. Garancia e Zbatimit

- 53.1 Koncesionari, me shpenzimet e tij, do t'i japë Autoritetit Garancinë e Zbatimit nga një bankë me reputacion ose shoqëri sigurimi e miratuar nga Autoriteti për një shumë të barabartë me 1,000,000 Euro (nje milion) tërësisht sipas formës së Aneksit 12. Kjo Garanci Zbatimi do të mbetet e vlefshme dhe ne fuqi dhe do të ketë efekt për të paktën një vit nga data e lëshimit të tyre. Koncesionari do të rinovojë gjatë afatit të kësaj Kontrate, Garancinë e Zbatimit, kryesisht në të njëjtat kushte dhe do t'i japë çdo Garanci Zbatimi të rinovuar Autoritetit jo më vonë se dhjetë (10) Ditë Pune para mbarimit të afatit të Garancisë së Zbatimit së papaguar në atë kohë. Mosrinovimi i Garancisë së Zbatimit sipas Nenit 53.1 i jep të drejtë Autoritetit ndërpresë Garancinë e Zbatimit të papaguar në atë kohë.
- 53.2 Nëse Koncesionari është në shkelje të detyrimeve të tij sipas Nenit 53.1 dhe nuk e rregullon atë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas marrjes së njoftimit me shkrim nga Autoriteti, Autoriteti mundet që, pa referencë të mëtejshme të Koncesionarit, të zgjidhë këtë Kontratë.
- 53.3 Autoriteti do t'i japë Garancinë e Zbatimit Koncesionarit, brenda tridhjetë (30) ditëve pas datës së zgjidhjes, në mbarimin e afatit të kësaj Kontrate, me kusht që Koncesionari të mos jetë në Shkelje të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.
- 53.4 Nëse Koncesionari është në Shkelje sipas kësaj Kontrate, Autoriteti do të ketë të drejtë që pas mbarimit të ndonjë periudhe të faljes ose periudhe kurimi dhe dhënies se ndonjë njoftimi të kërkuar, dhe duke informuar Koncesionarin me shkrim dhe pa cënuar të drejtat e tjera të tij sipas kësaj Kontrate, për të kërkuar ndonjë shumë parash sipas Garancisë së Zbatimit të cilën Koncesionari është i detyruar t'i paguajë Autoritetit sipas kësaj Kontrate. Garancia e Zbatimit nuk do të kërkohe nga Autoriteti në rastin e një Force Madhore ose me shkaktimin e një Shkelje nga ana e Autoritetit.

54. Kalimi ose Rinovimi

Asnjë palë nuk ka të drejtë të kalojë, rinovojë ose transferojë këtë Kontratë, ose ndonjë të drejtë dhe/ose detyrime, që dalin sipas dhe në vijim të kësaj Kontrate ose ndonjë përfitimi ose interesi në këtë çështje, pa miratimin paraprak me shkrim të Palëve të tjera.

55. Heqja Dorë dhe Mjetet ligjore tërësore

55.1 Të drejtat dhe mjetet ligjore tërësore që parashikohen në këtë Kontratë mund të hiqen vetëm me shkrim nga Përfaqësuesi përkatës në një mënyrë që deklaron shprehimisht se heqja-dorë është e nënkuptuar, dhe kjo heqje-dorë do të jetë vepruese vetëm sa i përket rrethanave specifike të cilat i referohen.

55.2 Vetëm nëse një e drejtë ose mjet ligjor i një Pale parashikohet të jetë një e drejtë ose mjet ekskluziv, zbatimi i se cilës nga ajo Palë, nuk çënon të drejtat dhe mjetet ligjore të Palës tjetër. Cdo dështim për të zbatuar ose ndonjë vonesë në ushtrimin e një të drejte ose njeti ligjor nga secila Palë nuk do të përbëjë një heqje dorë të asaj të drejte ose mjeti ligjor ose të ndonjë të drejte apo mjeti ligjor tjetër.

55.3 Të drejtat dhe mjetet ligjore tërësore që parashikohen në këtë Kontratë janë kumulative dhe, vetëm nëse parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, nuk përjashtohen nga të drejtat dhe mjetet ligjore tërësore që parashikohen në ligj ose në kapital ose ndryshe sipas kësaj Kontrate.

56. Marrëdhëniet ndërmjet Palëve

Nothing in this Agreement is intended to create a partnership, or legal relationship of any kind that could impose liability upon one Party for the act or failure to act of any other Party, or to authorize any Party to act as an agent for any other Party. No Party shall have the authority to make representations or act in the name of, or on behalf of, or to otherwise bind any other Party

57. Parandalimi i Korrupsionit

57.1 Koncesionari nuk do t'i:

57.1.1 Ofrojë ose pranojë t'i japë ndonjë personi që punon për ose angazhohet nga Autoriteti ose ndonjë Institucion tjetër Shtetëror ndonjë dhuratë ose shpërblim tjetër që mund të veprojë si stimulim material ose shpërblim, për ndonjë veprim ose mosveprim në lidhje me këtë Kontratë, ose ndonjë kontratë tjetër ndërmjet Koncesionarit dhe

Autoritetit ose ndonjë Institucioni Shtetëror, duke përfshirë shpërblimin e tij për Koncesionarin dhe ndonjë prej të drejtave dhe detyrimeve të tij që përmbahen në të; as

- 57.1.2 do të lidhë këtë Kontratë nëse ka dijeni se, në lidhje me të, është paguar, ose do t'i paguhet ndonjë shumë parash ndonjë personi që punon për ose angazhohet nga Autoriteti ose ndonjë Institucion Shtetëror tjetër, ose për të cilën është lidhur një marrëveshje.
- 57.2 Nëse çdonjëra prej Palëve Kryesore ka dijeni për këtë Shkelje sipas Nenit 57.1, kjo Palë Kryesore do të njoftojë Palën tjetër Kryesore për këtë Shkelje dhe Koncesionari në këshillim me Autoritetin do të marrë të gjitha masat e duhura për riparimin. Nëse Koncesionari nuk arrin të marrë këto masa brenda një periudhe të përshtatshme kohe pas këtij njoftimi ose konsultimi, Autoriteti mund të zgjidhë këtë Kontratë me njoftim paraprak me shkrim.
- 57.3 Cdo zgjidhje sipas Nenit 57.2 nuk do të çënojë ndonjë të drejtë ose mjet ligjor i cili është shtuar ose i shtohet më pas Autoritetit.

58. Publiciteti dhe Emërtimi

- 58.1 Koncesionari nuk do të japë ndonjë deklaratë shtypi ose të publikojë këtë Kontratë ose përmbajtjen e saj, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit, miratimi i të cilit nuk duhet të mbahet ose të vonohet pa shkak.
- 58.2 Cdo Palë Kryesore i vërteton Palës tjetër Kryesore se asgjë në këtë Kontratë, qoftë e shprehur ose e nënkuptuar, nuk përbën mbështetjen ose miratimin e ndonjë prej produkteve ose shërbimeve të Palës tjetër Kryesore (duke përfshirë Sistemin) dhe cdo Palë Kryesore pranon të mos silllet në mënyrë të tillë që të nënkuptojë ose të shprehë ndonjë aprovim ose miratim të tillë. Për të shmangur dyshimin, asgjë në Nenin 58 nuk do të interpretohet si pengim ose kufizim i aftësisë së Koncesionarit për t'iu referuar Sistemit dhe Shërbimeve në materialet e tij të marketimit dhe për të ofruar informacionin për Sistemin dhe Shërbimet klientëve të tij të mundshëm.
- 58.3 Palët pranojnë se kjo Kontratë është shumë konfidenciale dhe përmban element të sigurisë kombëtare. Prandaj është në mirëkuptimin e përbashkët të Palëve që kjo Kontratë të mos publikohet në Fletoren Zyrtare pas ratifikimit nga Parlamenti Shqiptar. Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesës ka konfirmuar këtë mirëkuptim të Palëve.

59. Veçueshmëria

Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate shpallet e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme për ndonjë arsye nga një gjykatë me juridiksionin përkatës, kjo dispozitë do të veçohet pa cënuar dispozitat e tjera. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate që është themelore për përmbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate, është shpallur pjesërisht e pavlefshme, Koncesionari dhe Autoriteti do të fillojnë menjëherë bisedimet në mirëbesim për të riparuar këtë pavlefshmëri.

60. Sigurime të Mëtejshme Further Assurances

Cdo palë merr përsipër me kërkesë të Palës tjetër, dhe me shpenzime të Palës kërkuese, të bëjë të gjitha veprimet dhe të nënshkruajë të gjithë dokumentat të cilat mund të jenë të nevojshëm për ti dhënë efekt kuptimit të kësaj Kontrate.

61. Tërësia e Kontratës

61.1 Kjo Kontratë, së bashku me dokumentat e referuarar në të, përbën të gjithë kontratën dhe marrëveshjet midis palëve në lidhje me ecështjet e negociuara në të dhe zëvendëson, fshin dhe shfuqizon cdo kontratë të mëparshme midis Palëve në lidhje me këto çështje pavarësisht se në ndonjë kontratë apo marrëveshje është shprehur se do të jetë e vlefshme edhe pas zgjidhjes së saj.

61.2 Secila Palë pranon dhe bie dakort se nënshkrimi i kësaj Kontrate dhe dokumentave të referuar në të ata nuk mbështeten në dhe nuk do të kenë asnjë të drejtë në lidhje me ndonjë deklaratë, garanci apo angazhim (i bërë qoftë nga neglizhencë ose me pakorrektesë) përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë. E vetmja e drejtë në dispozicion të cdo Palë në lidhje me cdo deklaram, garanci apo pranim do të jetë për Mospërmbushje të kontratës sipas kushteve të kësaj Kontrate.

61.3 Asgjë në këtë Nen 61 do të veprojë për të përjastuar cdo përgjegjësi për mashtrim apo ndonjë çështje tjetër që nuk mund të përjashtohet sipas Ligjit.

62. Të Drejtat e Palëve të Treta

62.1 Subjekt i zbatimit të Nenit 42.7, një person i cili nuk është Palë në këtë Kontratë nuk ka asnjë të drejtë të zbatojnë ndonjë kusht të kësaj Kontrate por kjo nuk prek cdo të drejtë apo mjet ligjor të cdo personi i cili ekziston ose është në dispozicion ndryshe të këtij personi..

62.2 Çdo e drejtë e krijuar sipas Nenit 62 mund të ndryshohet apo shuhet nga Palët pa miratimin e palës së tretë përfituese.

63. Njoftimet

- 63.1 Cdo noftim i dhënë sipas ose në lidhje me këtë Kontratë do të jetë me shkrim, i nënshkruar nga ose në emër të Palë që e jep atë dhe do të shërbehet duke e dorëzuar atë personalisht ose duke e dërguar me postë të parapaguar, rekomande ose me regjistrim dorëzimi apo me faks në adresen dhe në vëmendje të Palës përkatëse që noftohet për atë qëllim ose në ndonjë adresë tjetër që palët mund të kenë përcaktuar në përputhje me këtë Nen. Njoftimet nuk do të dërgohen me postë elektronike (e-mail).
- 63.2 Cdo Kërkesë për Ndryshim do të jetë me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga Pala marrëse.
- 63.3 Një njoftim do të konsiderohet i marrë:
- 63.3.1 Nëse dorëzohet personalisht, në kohën e dorëzimit; ose
- 63.3.2 Në rast të postës së parapaguar të klasit të parë, tre (3) Ditë Pune nga data e postimit.
- 63.4 Në shërbimin e provës, do të jetë e mjaftueshme të provohet se zarfi që përmban njoftimin ishte dërguar Palë përkatëse në adresën e saj të njoftuar paraprakisht për marrjen e njoftimeve (ose sic mund të njoftohet ndryshe nga Palët) dhe dorëzuar qoftë në atë adresë apo në ruajtje të autoriteteve postale si postë e parapaguar e klasit të parë, dorëzim i regjistruar, postë rekomande apo leter me postë ajrore.

64. Gjuha

Kjo Kontratë do të përgatitet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Në rast të mospërputhjeve, kundërshtive, mosmarrëveshjeve, pretendimeve që mund të ketë ndërmjet tekstit shqip të kësaj Kontratë dhe tekstit anglisht të kësaj Kontrate, versioni anglisht i kësaj Kontrate do të mbizotërojë dhe do të jetë versioni i vetëm detyrues. Dokumentet e referuara apo dorëzuara sipas kësaj Kontrate do të jenë në gjuhën angleze dhe/ose gjuhën shqipe, ashtu sic do të kërkohet.

65. Ligji i zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 65.1 Kjo Kontratë do të rregullohet nga, dhe kjo kontratë do të shpjegohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 65.2 Cdo Mosmarrëveshje që rrjedh nga apo në lidhje me këtë Kontratë do të zgjidhet në përputhje me Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes të përcaktuara në Aneksin 15; duke patur parasysh që cdo palë do të ketë të drejtë të referojë cdo Mosmarrëveshje

- drejtpërdrejt tek Arbitrazhi ICC në përputhje me Nenin 65.3 duke i dërguar cdo Palë tjetër me një njoftim me shkrim për këtë referim.
- 65.3 Nëse ndonjë Palë referon një Mosmarrveshje tek Arbitrazhi ICC ose zbatimin e Procedurave të Zgjidhjes së Mosmarrveshjes rezultojnë në referim të një Mosmarrveshje tek Arbitrazhi ICC do të zbatohen procedurat e mëposhtme:
- 65.3.1 Numri i arbitrave do të jetë tre (3). Arbitrat do të emërohen në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit ICC. Vendi i arbitrazhit do të jetë Viena, Austri. Gjuha e Arbitrazhit do të jetë anglishtja. Kostot e arbitrazhit do të përcaktohen nga gjykata e arbitrazhit.
- 65.3.2 Subjekt i zbatimit të procedimeve të arbitrazhit, Palët heqin dorë në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar nga e drejta e tyre nga cdo formë apeli, rishikimi rekursi në cdo gjykatë shtetërore apo autoritet tjetër gjyqësor, për aq sa një heqje dorë e kësaj mënyre mund të bëhet në mënyrë të vlefshme.
- 65.4 Për aq sa Autoriteti, në çdo juridiksion në të cilin procedimet mund të dërgohen për përcaktimin e çdo çështje që lind sipas apo për zbatimin e kësaj Kontrate (duke përfshirë cdo procedim ndërmjetësimi ose ekzekutimi të ndonjë vendimi apo urdhri që rrjedh prej saj) mundet të ketë të drejtë të kërkojë apo ti akordohet për veten e tij ose për pronat, asetet apo të ardhurat e tij, imunitet nga paditë apo kërkesat (qoftë si ndihmë e ekzekutimit, para gjykimit apo ndryshe, qoftë mbi baza sovranitetit apo ndryshe), gjykimet apo proceset e tjera ligjore për aq sa në atë juridiksion mund ti atribuohet Autoritetit, ose pronave, aseteve apo të ardhurave të tij një imunitet i tillë (i kërkuar ose jo), Autoriteti me anë të kësaj Kontrate bie dakort në mënyrë të përvokueshme të mos kërkojë dhe heq dorë nga një imunitet i tillë në gjithë hapsirën e lejuar nga ligjet e atij juridiksioni, përveç se Autoriteti do të ketë të drejtë të pretendojë imunitet nga proceset gjyqësore, për sa i përket ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit, në lidhje me:
- (i) "ambjentet e misioneve" të tashme dhe të ardhme siç përcaktohen në Konventën e Viennes për Marrëdhëniet Diplomatike nënshkruar më 1961, "ambjentet konsullore" të tashme dhe të ardhme siç përcaktohen në Konventën e Viennes për Marrëdhëniet Konsullore nënshkruar më 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat apo mision diplomatik i Shqipërisë ose cdo agjenci në shërbim të tyre;
 - (ii) Cdo prone e paluajtshme e cila është subjekt i parashikimeve të nenit 3 paragrafet 1-3 të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pasuritë e paluajtshme të shtetit";
 - (iii) Cdo shume monetare apo fond që ka për qëllim përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë në bazë të traktateve

nderkombetare, konventave dhe/ose marreveshjeve te nenshkruara prej saj.

NË DËSHMI TË përmes së cilës kjo Kontratë është nënshkruar rregullisht nga Palët.

Nënshkroi për dhe në emër të **MINISTRISË
SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Nënshkrimi

Emri: Ridvan Bode

Pozicioni : Ministër i Financave

NËNSHKROI për dhe në emër të **SICPA
SECURITY SOLUTIONS ALBANIA SH.
P. K.**

Nënshkrimi

Emri: Giani Nigro

Pozicioni: Drejtor

NËNSHKROI për dhe në emër të **SICPA
SECURITY SOLUTIONS S.A.**

Nënshkrimi

Emri: Philippe Amon

Pozicioni: Bashke-Kryesuses Ekzekutiv

Nënshkrimi

Emri: Jean-Francois de Saussure

Pozicioni: Drejtor, Qeverite dhe Institucionet